

CILËSIA E TEKSTEVE SHKOLLORE NË KOSOVË



CILËSIA E TEKSTEVE SHKOLLORE NË KOSOVË

Cilësia e teksteve shkollore në Kosovë

Hartimit të këtij studimi i kontribuan:

Lindita Boshtrakaj, Ema Rraci, Kushtrim Bajrami

Prill 2019

Prishtinë

Publikuar nga projekti “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim - KEEN”

Për më shumë informata, ju lutem vizitoni: www.keen-ks.net

Design: *envinion*.



Ky studim është përgatitur me përkrahjen e projektit “Rrjeti i Kosovës për Arsim dhe Punësim - KEEN”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Ky projekt zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), në bashkëpunim me Agjencinë për Promovimin e Punësimit në Kosovë (APPK), Balkan Sunflowers Kosovo (BSFK), Akademinë për Trajnim dhe Asistencë Teknike (ATTA) dhe Stichting SPARK. Përmbajtja e këtij publikimi nuk do të konsiderohet në asnjë mënyrë si pasqyrim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

LISTA E SHKURTESAVE	6
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	7
2. HYRJE	9
3. KUADRI LIGJOR PËR HARTIMIN, VLERËSIMIN, MIRATIMIN DHE BOTIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE	13
4. MEKANIZMAT DHE PROCEDURAT PËR HARTIMIN DHE VLERËSIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE	17
5. CILËSIA E TEKSTEVE SHKOLLORE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR	19
5.1. Vlerësimi i përmbajtjes së teksteve shkollore.....	20
5.2. Vlerësimi i aspekteve didaktiko-metodike	22
5.3. Vlerësimi i gjuhës, strukturës dhe organizimit të përmbajtjes	23
5.4. Vlerësimi i faqosjes dhe ilustrimeve.....	24
6. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIME.....	26
SHTOJCAT	29
Shtojca 1: Lista e dokumenteve të shqyrtuara.....	29
Shtojca 2: Lista e zyrtarëve/ekspertëve të intervistuar	31
Shtojca 3: Lista e mësimdhënësve pjesëmarrës në fokus grupe	32
Shtojca 4: Përmbledhjet e diskutimeve nga fokus grupet	34
Shtojca 5: Pyetësi për vlerësimin e teksteve shkollore, i realizuar me mësimdhënësit pjesëmarrës në fokus grupe	46

Lista e shkurtesave

MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
IPK	Instituti Pedagogjik i Kosovës
KDSH	Këshilli Drejtues i Shkollës
KEPTSH	Këshilli i Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore

1. Përmbledhje ekzekutive

Studimi analizon kuadrin ligjor dhe mekanizmat institucional për vlerësimin dhe botimin e teksteve shkollore si dhe tekstet shkollore që aktualisht janë në shfrytëzim, nga perspektiva e përputhjes së tyre me kërkesat e Kornizës Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar. Qëllimi është që krahas analizës së teksteve shkollore, të identifikohen edhe mangësitë eventuale në kuadrin ligjor dhe në proceset e deritanishme të përgatitjes, vlerësimit, botimit dhe shpërndarjes së teksteve shkollore. Mbi këtë bazë ofrohen rekomandime për përmirësim të sistemit në funksion të ngritjes së cilësisë së teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore.

Për këtë qëllim, studimi kombinon hulumtimin primar të realizuar në formë të intervistave dhe fokus grupeve me analizën e dokumentacionit. Analiza e dokumentacionit përfshin legjislacionin në fuqi, politikat dhe rregulloret përkatëse të MASHT-it për hartimin, vlerësimin dhe botimin e teksteve shkollore, dokumentet kurrikulare si dhe raportet e hulumtimeve të realizuara në këtë fushë.

Për të kuptuar më mirë procesin e hartimit dhe vlerësimit të teksteve të reja shkollore dhe qasjen e MASHT-it ndaj këtij procesi, janë realizuar intervista me zyrtarë të lartë të divizioneve përkatëse në MASHT dhe IPK, anëtarë të Këshillit të ekspertëve për programe dhe tekste shkollore si dhe ekspert të arsimit të angazhuar për përkrahjen e MASHT-it në këto procese¹.

Mangësitë kryesore në kuadrin rregullativ në bazë të të cilit janë duke u hartuar dhe vlerësuar tekstet e reja, përfshijnë:

- Mungesa e përputhshmërisë ndërmjet dokumenteve që rregullojnë procesin e hartimit, vlerësimit dhe aprovimit të teksteve shkollore dhe materialeve mësimore;
- Mangësi në trajtimin e aspekteve themelore që rregullojnë këto procese dhe paqartësi të shumta procedurale;
- Shmangie e masave të rëndësishme në procesin e përgatitjeve për hartimin e teksteve të reja dhe në procesin e vlerësimit të tyre;
- Moskonsolidimi i mekanizmave për mbledhjen e vazhdueshme të të dhënave nga shkollat/komunat lidhur me cilësinë e teksteve shkollore.

Me qëllim që të identifikohen mangësitë kryesore që i karakterizojnë shumicën e teksteve që aktualisht janë në shfrytëzim, në këtë studim po ashtu janë analizuar tekstet shkollore.

¹ Shih Shtojca 2: Lista e zyrtarëve/ekspertëve të intervistuar.

Analiza e teksteve shkollore është realizuar kryesisht përmes fokus grupeve me mësimdhënës. Në këtë drejtim, 41 mësimdhënës të nivelit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë/gjimnaze² nga 11 komuna të ndryshme³ kanë shprehur perspektivën e tyre sa i përket cilësisë së teksteve shkollore dhe materialeve mësimore që aktualisht janë në shfrytëzim. Për validimin e të dhënave nga fokus grupet, përmbledhja e diskutimeve pas çdo takimi është ndarë me pjesëmarrësit për t'u siguruar se kontributi i tyre është përfshirë⁴.

Shqetësimet kryesore të mësimdhënësve sa i përket cilësisë së teksteve shkollore përfshijnë⁵:

- Mungesa e aktualitetit, relevancës dhe përputhshmërisë me kurrikulën e re;
- Mbingarkesa (me tema, tekst, fakte, formula);
- Përmbajtja e fakteve të pasakta dhe koncepteve të padefinuara mirë;
- Mungesa e balancës në gjerësinë dhe thellësinë e trajtimit të temave;
- Mungesa e perspektivës së shumëfishtë në trajtimin e temave;
- Strukturimi jo adekuat dhe konsistent i përmbajtjes;
- Mungesa e referencës në burime plotësuese për informata shtesë;
- Mospërshtatja me nivelin kognitiv të nxënësve;
- Mungesa e ndërlikohjes/mundësisë për tu ndërlikuar me informatat dhe përvojat paraprake të nxënësve;
- Mungesa e korrelacionit ndër-kurrikular;
- Mungesa e rezultateve të pritura në fillim të çdo njësie/teme mësimore dhe kritereve të suksesit në fund të secilës njësi;
- Pamundësia për shfrytëzim fleksibil të tekstit, konform aftësive dhe stileve të ndryshme të të nxënëtit;
- Fokus në informata/fakte dhe reproduktim;
- Ilustrime jo adekuate, jo funksionale dhe jo atraktive për nxënësin.

Nisur nga kjo, por edhe nga studimet tjera që trajtojnë tekstet shkollore standardet dhe treguesit për vlerësimin e teksteve shkollore do të duhej të rishikohen duke siguruar që mangësitë e lartpërmendura të kenë vëmendjen e duhur.⁶ Përgatitja e udhëzuesve përkatës për botuesit/autorët e teksteve shkollore dhe planifikimi i programeve të trajnimit për ta është po ashtu një domosdoshmëri.

Nga ana tjetër, kuadri institucional dhe rregullativ për hartimin, vlerësimin, miratimin dhe botimin e teksteve shkollore duhet të plotësohet dhe harmonizohet në mënyrë që të jetë në funksion të ngritjes së cilësisë së teksteve shkollore. Ndërsa, koordinimi ndërmjet organeve administrative, arsimore dhe teknike duhet të fuqizohet në mënyrë që burimet ekzistuese të shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe efikente për përmirësimin e dizajnit, prodhimit dhe shpërndarjen e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore.

2 Shih Shtojca 3: Lista e pjesëmarrësve në fokus grupe.

3 Prishtinë, Gjiilan, Prizren, Rahovec, Viti, Istog, Gjakovë, Fushë Kosovë, Vushtrri, Lipjan dhe Obiliq.

4 Shih Shtojca 4: Përmbledhje e diskutimeve me fokus grupet.

5 Në listën më poshtë janë përfshirë vetëm mangësitë për të cilat shqetësimin e kanë shprehur mbi 90% e mësimdhënësve.

6 Gjuha diskriminuese në tekstet shkollore- Analizë e teksteve shkollore të nivelit të mesëm të lartë, YIHR, Prishtinë, 2017.



Problemet dhe të metat e teksteve shkollore-Analizë e teksteve shkollore të Kosovës të ciklit të shkollës së mesme të ulët (klasët VI, VII, VIII, IX), BIRN, Prishtinë, 2010.

Problemet dhe të metat e teksteve shkollore-Analizë e teksteve shkollore të Kosovës të ciklit të shkollës së mesme të ulët (klasët VI, VII, VIII, IX)- rishqyrtim i çështjeve të ngritura në studimin e vitit 2010, BIRN, Prishtinë, 2013.

2. Hyrje

Me Kornizën Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar, MASHT-i është përcaktuar për një qasje të bazuar në kompetenca, përkatësisht qasje të orientuar kah rezultatet e pritura që duhet të arrihen nga të gjithë nxënësit në periudha të ndryshme të shkollimit. Për të siguruar koherencën dhe konsistencën e procesit të zbatimit të kësaj qasje, Korniza Kurrikulare vendos pesë parime themelore të cilat duhet të udhëheqin të gjithë procesin e zbatimit të reformës kurrikulare. Si të tilla, këto parime duhet të udhëheqin edhe procesin e përgatitjes dhe aprovimit të teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore.

Në vijim përshkruhen implikimet kryesore të parimeve të kurrikulës në përgatitjen, vlerësimin dhe procedurat e përzgjedhjes së teksteve shkollore:

- 
Gjithëpërfshirja, i referohet të drejtës së secilit fëmijë dhe të ri për përfshirje të barabartë në arsim cilësor. Bazuar në këtë parim, teksti shkollor duhet të mundësoj përfshirje/ndërveprim me secilin nxënës/e, duke kontribuar në realizimin e plotë të potencialit individual të secilit/ës. Nisur nga kjo, përmbajtja kryesore e tekstit për secilën temë duhet të jetë “përmbajtje bërthamë”, e kapshme për secilin nxënës/e, ndërsa aparatura didaktike duhet t’i orientoj nxënësit/et në burime shitesë konform interesimit dhe kapacitetit të tyre individual. Pra, përmbajtja duhet të jetë e vetëmjaftueshme për të mundësuar arritjen e rezultateve të të nxënës, por pa asnjë informatë të tepërt, që nuk është e domosdoshme për absorbimin e temës. Përmbajtja, para së gjithash, duhet ofruar si mjet për arritjen e rezultateve të të nxënës dhe jo si qëllim në vete. Për inkurajimin e leximit të pavarur plotësues nga nxënësit/et, lista e burimeve të rekomanduara duhet të vendoset në fund të çdo teme.
- 
Zhvillimi i kompetencave, nënkupton arritjen e matshme të dijeve, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave, të cilat shoqëria i konsideron të domosdoshme për të gjithë qytetarët e Kosovës. Në sistemin e kurrikulës, kompetencat kryesore zërthehen nëpërmjet rezultateve të të nxënës që duhet të arrihen në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme nga të gjithë nxënësit gjatë arsimit parauniversitar, respektivisht deri me rastin e përfundimit të klasës së 12-të. Mbi këtë bazë, çdo tekst shkollor (dhe çdo hollësi brenda tekstit), krahas kontributit në arritjen e rezultateve të të nxënës të parapara për lëndën dhe fushën përkatëse, duhet të jetë edhe në funksion të zhvillimit të kompetencave kryesore të përcaktuara me Kornizën kurrikulare në Kosovë. Në këtë kontekst, çdo tekst shkollor para së gjithash duhet t’i kontribuoj kultivimit të kërkuesisë së natyrshme të nxënësve/eve, zhvillimit të mendimit kritik dhe kreativitetit, aftësimin për të nxënë të pavarur dhe zhvillimit të shkathtësive të larta intelektuale, për të vazhduar me kompetencat tjera që mund të jenë më tepër në përqendrim të njëjës apo tjetrës lëndë/fushë kurrikulare. Vëmendje të veçantë në këtë kontekst, krahas përmbajtjes adekuate të tekstit dhe aparaturës didaktike, duhet t’i kushtohet edhe shkarkimit nga përmbajtjet e tepërta në mënyrë që mësimdhënësit/et të kenë kohën e

mjaftueshme për shfrytëzimin e temave përkatëse në funksion të zhvillimit të kompetencave dhe arritjes së rezultateve të nxënies⁷.

► **Mësimdhënia dhe të nxëniet e integruar**, nënkupton të nxëniet e plotë që reflekton ndërlidhjet dhe ndërvarësitë e natyrës dhe të botës së krijuar nga njeriu me dijen dhe informacionin që kemi për to. Të udhëhequr nga ky parim tekstet shkollore duhet të mundësojnë:

- ndërlidhjen kuptimplote të mësimin me jetën, përmes përmbajtjeve mësimore që reflektojnë preokupimet e nxënësve, të shoqërisë dhe të mjedisit në të cilin vepron shkolla dhe më gjerë;
- ndërlidhjen me informatat paraprake të nxënësit/es, organizimin dhe integrimin e përmbajtjes së re me informatat paraprake, reflektimin për gjërat që janë mësuar dhe transferimin e dijes në kontekste të reja;
- shfrytëzimin e mjeteve, situatave dhe burimeve rrethore për realizimin e proceseve mësimore;
- zbatimin e dijes dhe shfrytëzimin e shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave të caktuara në kontekst të zgjidhjes së problemeve praktike dhe reale të jetës së përditshme;
- ndërlidhjen ndërmjet lëndëve dhe fushave kurrikulare në funksion të një procesi të plotë dhe të shumanshëm mësimor që vë në pah ndërlidhjen e aspekteve të ndryshme të proceseve mësimore që trajtohen në kuadër të fushave të ndryshme kurrikulare;

► **Autonomia dhe fleksibiliteti në nivel shkollë**, i mundëson shkollës të ndërtoj profilin e vet në interesin më të mirë të nxënësve të saj dhe të lokalitetit në të cilin vepron, në përputhje me kushtet specifike të kuadrit mësimor dhe infrastrukturës së saj dhe brenda kuadrit rregullativ të vendosur nga MASHT-i. Në raport me tekstet shkollore, ky parim i mundëson shkollave që, nga lista e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore të aprovuara nga MASHT, të përzgjedhin tekstet dhe materialet konform nevojave arsimore të nxënësve/eve të tyre, nevojave të personelit mësimor dhe veçorive të komunitetit në të cilin vepron shkolla. Përveç kësaj, struktura e njësive mësimore në kuadër të teksteve shkollore duhet të mundësoj shfrytëzim fleksibil, duke u organizuar në pjesë të pavarura (me mundësi fleksibile të ndërlidhjes konform veçorive të komunitetit ku vepron shkolla dhe nevojave të nxënësve). Për shembull, pjesa bërthamë që është e domosdoshme për arritjen e rezultateve të të nxëniet duhet të funksionoj në mënyrë të pavarur nga pjesa plotësuese e cila mund të shfrytëzohet në mënyrë fleksibile nga mësimdhënësit.

► **Përgjegjësia dhe llogaridhënia**, nënkupton që procesi i decentralizimit të shërbimeve arsimore dhe rritja e autonomisë së shkollës duhet të shoqërohet nga një mekanizëm funksional për sigurim të cilësisë dhe llogaridhënies për tërë hierarkinë e sistemit të arsimit. Ky parim, në raport me tekstet shkollore, vë në pah përgjegjësinë e shkollave për zgjedhje adekuate të teksteve shkollore sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga MASHT. Përveç kësaj, ky parim nënkupton edhe përgjegjësinë e shkollave që t'i evidentojnë dhe raportojnë mangësitë eventuale në tekstet përkatëse duke i kontribuar ngritjes së cilësisë së teksteve shkollore. Për këtë qëllim, vendosja e një mekanizmi për mbledhjen e vazhdueshme të të dhënave nga shkollat/komunitat lidhur me cilësinë e teksteve shkollore është e domosdoshme.

7 Nëse për çdo temë/njësi kemi vetëm një orë mësimore, automatikisht e minojmë trajtimin adekuat të asaj teme në funksion të zotërimit të kompetencave duke u përqendruar vetëm në memorizimin dhe eventualisht përvetësimin e fakteve.

Përveç parimeve të përgjithshme, në raport me tekstet shkollore dhe materialet tjera mësimore, Korniza Kurrikulare vendos edhe kriteret kryesore që përcaktojnë cilësinë e teksteve shkollore. Bazuar në këto kriteret, tekstet shkollore duhet të mundësojnë:

- mësimdhënie dhe nxënie që në mënyrë të balancuar siguron përvetësimin e dijeve, zhvillimin e shkathtësive dhe qëndrimeve intelektuale;
- zbatimin e metodave interaktive të mësimdhënies dhe nxënies (si dhe procedurave të vlerësimit), të cilat ndihmojnë zhvillimin e kreativitetit dhe zgjidhjen e pavarur të problemeve;
- promovimin e vlerave pozitive, parimeve dhe përvojave, si: të drejtat e njeriut, drejtësinë sociale dhe gjithëpërfshirjen;
- shmangien e paragjykimeve dhe stereotipave, qëndrimeve diskriminuese, urrejtjes dhe dhunës;
- aktivitete relevante dhe të përshtatshme për vlerësim dhe vetëvlerësim, si dhe aktivitete të cilat përkrahin zhvillimin e kompetencës për të mësuar;
- ndërlidhjen me lëndët dhe fushat kurrikulare nëpër shkallë/nivele të kurrikulës.

Korniza Kurrikulare thekson nevojën për evitimin e të nxënit rutinor e memorizues dhe inkurajimin e pjesëmarrjes aktive dhe kreative gjatë përvetësimit të dijeve relevante, zhvillimit të shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve të cilat shpijnë drejt zotërimit gradual të gjashtë kompetencave kryesore⁸.

Përkundër që zbatimi i kurrikulës së re në mbarë vendin ka filluar që nga viti shkollor 2017-2018, ndërsa faza e parë e pilotimit që në vitin shkollor 2013/2014, përgatitja e teksteve shkollore sipas kërkesave të reja të Kornizës Kurrikulare ka filluar në vitin 2018⁹. Sipas Udhërrëfyesit për zbatim të kurrikulës 2016-2021, tekstet e reja shkollore për klasat 0, 1, 6 dhe 10 do të duhej të ishin të gatshme për vitin shkollor 2017/2018, kur edhe ka filluar zbatimi i kurrikulës së re në këto klasë, për të vazhduar procesin në mënyrë graduale deri në kompletimin e pakos së teksteve për arsimin parauniversitar¹⁰.

Përkundër mungesës së teksteve të reja, mbështetja e shkollave/mësimdhënësve për shfrytëzimin e teksteve aktuale konform frymës së re të kurrikulës ka qenë e pamjaftueshme. Divizioni për kurrikula dhe tekste shkollore në MASHT është përpjekur që të hartojë udhëzime për përdorimin e teksteve të vjetra sipas kurrikulës së re, por përmbajtja e tyre nuk i plotëson kërkesat dhe nevojat e mesimdhënësve për një orientim më të qartë se si t'i qasen shfrytëzimit të teksteve aktuale konform frymës së re të kurrikulës.

Nga ana tjetër, edhe orientimet e ofruara në Kurrikulat Bërthamë janë shumë të përgjithshme, me theks në mundësinë e shfrytëzimit të teksteve dhe materialeve alternative, por nuk u ndihmojnë mesimdhënësve që të ri-pozicionohen në raport me tekstet shkollore¹¹. Situata është e ngjashme edhe në kurrikulat lëndore/

8 Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Kosovës, MASHT, Prishtinë, 2016, faqe 53.

9 Aktualisht është duke u bërë vlerësimi dhe finalizimi i teksteve shkollore për klasën parafillore, klasën e parë, të gjashtë dhe të dhjetë (në të cilat edhe ka filluar zbatimi i kurrikulës së re në vitin 2017/2018), me tendencën që të jenë të gatshme për vitin shkollor 2019/2020.

10 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016). Udhërrëfyes për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021. (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/udherrefyes-per-zbatimin-e-kk-2016-2021-final.pdf>)

11 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2016). Kurrikula Bërthamë për Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor të Kosovës (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf>), fq. 35, 44, 53, 61, 79, 87. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2016). Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës

programet mësimore të përgatitura për klasën përgatitore, klasën e parë, të dytë, të gjashtë, të shtatë, të dhjetë dhe të njëmbëdhjetë¹². Udhëzimet përqendrohen kryesisht në shfrytëzimin e mjeteve didaktike, por pa sqarime për përshtatshmërinë/diskrepancën ndërmjet teksteve aktuale dhe programeve të reja mësimore dhe për mënyrën e shfrytëzimit efektiv të teksteve aktuale, apo përzgjedhjen adekuate të teksteve alternative. Përfundimisht këtu bëjnë programet mësimore për gjuhët e huaja dhe për edukatën muzikore, të cilat ofrojnë edhe një listë të burimeve online që mund të shfrytëzohen nga mësimmshënësist.

(https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-berthame-2-final_1.pdf), fq. 35, 45, 54, 64, 73, 82, 90.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2016). Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë të Kosovës

(<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-berthame-3-final.pdf>), fq. 36, 45, 54, 64, 72, 81, 89.

12 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/Programet mësimore, Klasa përgatitore

(<https://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>)

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/Programet mësimore, Klasa e parë

(<https://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>)

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/Programet mësimore, Klasa e dytë

(<https://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>)

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/Programet mësimore, Klasa e gjashtë

(<https://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>)

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/Programet mësimore, Klasa e shtatë

(<https://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>)

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/Programet mësimore, Klasa e dhjetë

(<https://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>)

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/Programet mësimore, Klasa e njëmbëdhjetë

(<https://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>)

3. Kuadri ligjor për hartimin, vlerësimin, miratimin dhe botimin e teksteve shkollore

Hartimi i teksteve të reja shkollore bazohet në Ligjin Nr.02/L-67 për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik. Ky ligj e përcakton tekstin shkollor si libër themelor dhe të obligueshëm që shërben si mjet themelor dhe burim i dijes për fushën e caktuar dhe me shfrytëzimin e të cilit arrihen objektivat edukativo-arsimore të përfshira në plan dhe program mësimor¹³. Për më shumë, ligji përcakton në mënyrë të përgjithshme procedurat për vlerësimin dhe lejimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore dhe dokumentacionit pedagogjik, por nuk përcakton përbërjen e ekipit të recensentëve, procedurën e rishikimit të teksteve në bazë të komenteve të recensentëve dhe procedurën e vlerësimit përfundimtar të tyre. Dispozitat ligjore i japin të drejtë mësimdhënësve, përkatësisht shkollave të zgjedhin përdorimin e tekstit shkollor nga katalogu i teksteve shkollore të publikuar nga MASHT, por në anën tjetër, neni 11, paragrafi 11.4 përcakton që botuesi duhet të shtyp aq kopje sa t'i plotësoj kërkesat e nxënësve¹⁴. Procedura e përzgjedhjes së teksteve me të cilat MASHT i furnizon shkollat dhe forma e përfshirjes së shkollave në këtë proces mbeten të papërcaktuara. Si rrjedhojë, në praktikën e deritanishme të furnizimit të shkollave me tekste shkollore, shkollave nuk iu është ofruar mundësia e përzgjedhjes së tyre.

Bazuar në “Strategjinë për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007-2017”, MASHT në vitin 2011 kishte nxjerrë Udhëzimin Administrativ Nr. 05/2011 për zbatimin e standardeve për tekstet shkollore, ku përcaktohen kriteret dhe aspektet të cilat duhet t'i plotësojnë tekstet shkollore¹⁵. Në pjesën e parë të këtij akti nënligjor përshkruhen 15 standarde të përgjithshme, të cilat vlejné për të gjitha tekstet shkollore, dhe të cilat trajtojnë aspektet formale, paraqitjen dhe pamjen; aspektet metodike dhe didaktike; aspektet pedagogjike; dhe aspektet në lidhje me praktikën. Në pjesën e dytë përcaktohen standardet specifike për secilën lëndë. Përpjekjet për të vlerësuar një tekst shkollor duke u bazuar në këto standarde tregojné se strukturimi i tyre sipas aspekteve të lartcekura nuk është shumë praktik për vlerësuesin (recensentin, mësimdhënësin apo prindin). Në këtë drejtim, Standardi 5 i cili përshkruan përshtatshmërinë me moshën e nxënësve është në kuadër të aspekteve metodike dhe didaktike, por ky standard është relevant për çdo aspekt tjetër, prandaj në mënyrë adekuate do të duhej të përshkonte të gjitha aspektet, përkatësisht standardet tjera, përmes treguesve përkatës.

13 Ligji Nr.02/L-67 për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik. (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2437>)

14 Po aty, neni 11.

15 Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2011 Zbatimi i standardeve për tekstet shkollore. (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/standardet-e-teksteve.pdf>)

Për t'iu shmangur përsëritjeve dhe për të thjeshtësuar procesin, por njëkohësisht duke trajtuar të gjitha aspektet e rëndësishme për vlerësimin e teksteve, një formë më praktike do të ishte që përqendrimi me rastin e vlerësimit të jetë në aspektet e përmbajtjes së tekstit, ku theksohet ndërlidhja me kurrikulën, saktësia, aktualiteti dhe relevanca e të dhënave, qartësia e koncepteve, koherenca e ideve, thellësia dhe gjerësia adekuate e trajtimit të temave e të tjera; në aspektet e mësimdhënies dhe mësimnxënies, përkatësisht aspektet pedagogjike, didaktike dhe metodike në frymën e kurrikulës së re; aspektet e strukturës dhe organizimit, ndarja në njësi dhe hapa të përshtatshëm pune, pjesët përbërëse të njësive/temave mësimore, radhitja adekuate e njësive mësimore e të tjera; aspektet gjuhësore, që lehtësojnë dhe motivojnë të nxënit dhe të kuptuarit, duke i kontribuar edhe zotërimit të gjuhës standarde; dhe aspektet formale si dizajni, faqosja, paraqitja grafike, pesha e të tjera. Një ndarje e tillë do të thjeshtësonte po ashtu punën e ekipit të recensentëve, përkatësisht ndarjen e detyrave ndërmjet tyre në procesin e vlerësimit të teksteve shkollore.

Për më shumë, theksi i Standardit 1 vendoset te përputhshmëria me kurrikulën dhe tekstet shkollore të së njëjtës lëndë në klasat pararendëse, që është një aspekt shumë i rëndësishëm, por çështja e përputhshmërisë me kurrikulën dhe tekstet shkollore ndërmjet lëndëve të ndryshme në klasën e njëjtë (koherenca horizontale) nuk është trajtuar mjaftueshëm në kuadër të standardeve të përgjithshme. Kriteria tjera të rëndësishme, që nuk janë trajtuar mjaftueshëm në kuadër të standardeve për tekstet shkollore janë edhe aspektet e mëposhtme:

- ndërlidhja me informatat paraprake të nxënësit/es, përmes pyetjeve përkatëse në pjesën hyrëse të njësive mësimore për të mundësuar organizimin dhe integrimin e përmbajtjes së re me informatat paraprake,
- atraktiviteti i përmbajtjeve që shtjellohen, përkatësisht i mënyrës së si ofrohen, ashtu që t'i përfshijnë dhe motivojnë nxënësit/et për të mësuar,
- përqendrimi i vetëm në përmbajtjet thelbësore për arritjen e rezultateve të të nxënit, për t'iu shmangur mbingarkesës, si dhe
- pesha e teksteve shkollore, duke pasur parasysh peshën e çantave të nxënësve.

Ky dokument, krahas pakos kurrikulare është shfrytëzuar në procesin e vlerësimit të teksteve që aktualisht janë në proces të rishikimit dhe aprovimit. Megjithatë, përkundër mangësive të lartcekura, ky dokument ka mundur të shfrytëzohet edhe si një mjet i rëndësishëm për udhëzimin e shkollave dhe mësimdhënësve gjatë periudhës së zbatimit të kurrikulës së re me tekste të vjetra shkollore. Në këtë mënyrë mësimdhënësit do ta kishin më të qartë se si t'i shfrytëzojnë tekstet aktuale në mënyrë kritike dhe kreative, por edhe si t'i përzgjedhin burimet alternative apo t'i përgatisin materialet plotësuese. Për këtë qëllim, referenca të drejtpërdrejta në standardet/treguesit përkatës kanë mundur të bëhen në kuadër të kurrikulave bërthamë por edhe në kuadër të programeve mësimore të zhvilluara nga MASHT-i. I njëjti ka mundur të shfrytëzohet edhe për përgatitjen e udhëzuesve për shkollat si dhe për autorët e teksteve shkollore/shtëpitë botuese, para fillimit të hartimit të teksteve të reja shkollore.

Me qëllim të plotësimit të procedurave për vlerësimin dhe lejimin e teksteve shkollore si dhe reflektimit të kërkesave të pakos së re kurrikulare, MASHT-i është në proces të përgatitjes së projektligjit të ri për tekstet

shkollore, mjetet dhe materialet mësimore, lekturën shkollore dhe dokumentacionin pedagogjik në arsimin parauniversitar¹⁶. Ky projektligj deri me datë 5 shkurt 2019 ka qenë i hapur për diskutim publik dhe së shpejti pritet të dorëzohet në Qeveri për aprovim¹⁷. Qëllimi i këtij projektligji është:

- Përcaktimi i normave dhe koncepteve themelore për zhvillimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik në nivelin parauniversitar;
- Përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të MASHT-it, të autorit, të botuesit, komunave, shkollave dhe palëve tjera të interesit;
- Krijimi i kushteve të konkurrencës së lirë dhe ndalimi i konfliktit të interesit për hartimin dhe botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës dhe të dokumentacionit pedagogjik.

Megjithatë, procedura e aprovimit dhe ajo e botimit të teksteve shkollore vazhdon të jetë e paqartë. Në parim, vihet re tendenca që shkollat të përfshihen në procesin e përzgjedhjes së teksteve shkollore nga katalogu i teksteve të lejuara nga MASHT-i, por procedura e porositjes së teksteve për botim, e teksteve që ofrohen falas nga MASHT-i nuk përcaktohet. Dispozitat e këtij projektligji parashohin që tirazhi i teksteve shkollore dhe materialeve tjera të përcaktohet nga MASHT në përputhje me nevojat e shkollave¹⁸. Në këtë mënyrë mund të nënkuptohen vetëm nevojat sa i përket numrit të nxënësve siç është interpretuar edhe në praktikën aktuale, pasi që këto dispozita në mënyrë të njëjtë janë rregulluar edhe me ligjin që aktualisht është në fuqi.

Po ashtu UA 22/2016 në kuadër të detyrave dhe përgjegjësisë të aktiveve profesionale parashihet propozimin për drejtorin e shkollës/KDSH e burimeve, mjeteve dhe materialeve të tjera mësimore, por gjuha e përdorur nuk lë të nënkuptohet qartë se aktivet bëjnë përzgjedhjen e teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore nga lista e teksteve dhe materialeve mësimore të aprovuara nga MASHT, si bazë për porosinë e botimit të teksteve dhe materialeve të tjera të cilat ofrohen falas nga MASHT¹⁹. Në këtë drejtim, nevojitet që procesi, detyrat dhe përgjegjësitë e shkollave, këshillit të ekspertëve për programe dhe tekste shkollore (KEPTSH) dhe MASHT-it në procesin e përzgjedhjes dhe porosisë së teksteve të cilat financohen nga MASHT-i të jenë më të qarta.

Projektligji po ashtu nuk rregullon përbërjen KEPTSH-it, duke përcaktuar që përgjegjësitë dhe financimi i saj përcaktohen me akt nënligjor nga MASHT-i²⁰.

Një aspekt tjetër që nuk trajtohet mjaftueshëm në projektligj është edhe procesi i tërheqjes së teksteve dhe materialeve mësimore nga përdorimi, përmirësimi i mangësive eventuale apo edhe avancimi i vazhdueshëm

16 Sipas Udhërrëfyesit për zbatimin e kurrikulës 2016-2021, ky proces do të duhej të përfundoj kohë më parë, në mënyrë që t'i paraprij procesit të hartimit dhe miratimit të teksteve të reja shkollore (shih: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2016). Udhërrëfyes për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021. (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/udherrefyes-per-zbatimin-e-kk-2016-2021-final.pdf>)

17 <http://konsultimet.rks-gov.net/vieëConsult.php?ConsultationID=40560>

18 Po aty, fq. 19.

19 Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë. (2016). Udhëzimi Administrativ nr. 22/2016 Për Aktivet Profesionale (Departamentet) të Shkollave. (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/22-ua-nr-22-2016-per-aktivitetet-profesionale-te-shkollave.pdf>)

20 Projektligji për tekstet shkollore, mjetet dhe materialet mësimore, lekturën shkollore dhe dokumentacionin pedagogjik në arsimin parauniversitar (<http://konsultimet.rks-gov.net/vieëConsult.php?ConsultationID=40560>), neni 10, paragrafi 4, fq. 10.

i cilësisë së tyre. Roli i shkollave në këtë proces dhe vendosja e një mekanizmi për përmirësimin e gabimeve dhe/apo ngritjen e cilësisë së teksteve shkollore nuk është përcaktuar fare.

Së fundi, çështja e përkthimit dhe përshtatjes së teksteve nga vendet tjera duhet të precizohet në projektligjin për tekstet shkollore, duke i hapur rrugë rritjes së konkurrencës dhe mundësive për ngritje të cilësisë së teksteve shkollore.

4. Mekanizmat dhe procedurat për hartimin dhe vlerësimin e teksteve shkollore

Sipas Ligjit Nr. 02/L-67, procedura e hartimit dhe e botimit të teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik mbikëqyret nga Këshilli i Ekspertëve i Programeve dhe Teksteve Shkollore (KEPTSH)²¹. Sipas planit dinamik për përgatitjen e teksteve të reja shkollore, të përgatitur nga KEPTSH, në muajin prill 2018 është shpallur konkursi për tekstet e reja për klasën përgatitore dhe klasët 1, 6 dhe 10, për vitin shkollor 2019/2020. Aktualisht KEPTSH është në proces të shqyrtimit të vlerësimeve të recensentëve.

Në vendimin 251/01B të MASHT-it për emërimin e KEPTSH²² dhe në Rregulloren e KEPTSH-it, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësisve të këtij organi parashihet mbështetja e programit të trajnimit për autorët e teksteve shkollore dhe shtëpitë botuese, si dhe krijimi i mekanizmave për mbledhjen e vazhdueshme të të dhënave nga shkollat/komunat lidhur me cilësinë e teksteve shkollore. Mirëpo, këto obligime nuk janë përmbushur nga KEPTSH, dhe këto masa nuk janë paraparë fare në kuadër të planit dinamik të KEPTSH-it për përgatitjen e teksteve të reja.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm që nuk parashihet fare me planin dinamik të KEPTSH-it për përgatitjen e teksteve të reja është edhe testimi i teksteve shkollore, pas vlerësimit të recensentëve dhe rekomandimit për përdorim. Marrë parasysh cilësinë e teksteve aktuale dhe përvojën jo të mirë në zhvillimin e deritanishëm të teksteve shkollore, këto masa kanë rëndësi të veçantë dhe nuk do të duhej të anashkalohehin. Ato janë hallka të domosdoshme të procesit të hartimit dhe miratimit të teksteve. Për më shumë, procesi i përzgjedhjes së teksteve shkollore nga shkollat, para porosisë së botimit, po ashtu nuk parashihet fare në planin dinamik të KEPTSH-it²³.

Sa i përket procesit të vlerësimit dhe miratimit të teksteve shkollore, UA 18/2018 për recensentët, vlerësimin dhe lejimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore përcakton kriteret për përzgjedhjen e recensentëve, detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, procedurat e vlerësimit të dorëshkrimeve dhe materialeve mësimore deri në miratimin e tyre për botim²⁴. Në kuadër të kriterëve për përzgjedhjen e recensentëve që përcaktohen me këtë

21 Ligji Nr.02/L-67 për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2437>), neni 4 paragrafi 4.2, fq.3.

22 Vendimi nr 251 për emërimin e Këshillit të ekspertëve për programe dhe tekste shkollore (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/04/vendim-refnr-251-01b-dt-090218-per-emerimin-e-keptsh-251.pdf>), pika 2.6 dhe 2.7.

23 Pas ankesave eventuale nga botuesit, tekstet e miratuara përpunohen, shtypen dhe janë të gatshme për tu shpërndarë në shkolla.

24 UA 18/2018 për Recensentët, vlerësimin dhe lejimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/12/ua-nr-18-18-per-recensentet-vleresimin-dhe-lejimin-e-teksteve-shkollore-dhe-mat-shkollor-x.pdf>)

akt nënligjor, përvoja në procesin e zhvillimit dhe zbatimit të kurrikulës së re nuk parashihet fare²⁵. Marrë parasysh edhe faktin se për recensentët e përzgjedhur nuk është ofruar ndonjë program trajnimi për implikimet e parimeve kryesore të kurrikulës në tekstet shkollore, gjasat që tekstet të vlerësohen bazuar mbi këto parime janë më të ulëta.

Procesi i vlerësimit të dorëshkrimeve përqendrohet vetëm në vlerësimin e parë, për të cilën përcaktohen afatet kohore, por nuk përcaktohet edhe procedura e vlerësimit përfundimtar të dorëshkrimeve të rishikuara nga shtëpitë botuese, në bazë të rekomandimeve të recensentëve²⁶. Neni 8, paragrafi 6 parasheh që në rastet kur sipas recensionit kërkohen plotësime të dorëshkrimit, MASHT jep 30 ditë afat shtëpisë botuese/autorit për plotësim të dorëshkrimit, por nuk përcakton rolin e recensentëve, afatin kohor dhe procedurën e vlerësimit përfundimtar të dorëshkrimeve të rishikuara.

Testimi i teksteve shkollore në shkolla nuk parashihet as me këtë akt nënligjor, përkundër që standardi 15 për tekste shkollore parasheh një masë të tillë²⁷. Sipas nenit 10 të UA 18/2018, paragrafi 1, KEPTSH pas shqyrtimit të raporteve vlerësuese i propozon ministrit listën përfundimtare të teksteve shkollore.

Një aspekt tjetër i papërcaktuar në këtë akt nënligjor është edhe procesi i vlerësimit të dorëshkrimeve nga komisioni recensues. Neni 5 përcakton përbërjen e këtij komisioni nga 5 anëtarë (mësimdhënës universitar, punonjës shkencor, mësimdhënës parauniversitar dhe 2 anëtarë sipas natyrës së dorëshkrimit-që mund të jenë pedagog, psikolog, gjuhëtar, ekspert nga fusha artistike dhe/apo ekspert për vlerësim të aspekteve teknike të dorëshkrimit), mirëpo nuk përcakton nëse secili recensent vlerëson vetëm përputhmërinë me standarde të caktuara, konform përgatitjes dhe thirrjes profesionale apo secili prej tyre vlerëson të gjitha aspektet e cilësisë së teksteve shkollore²⁸. Sipas intervistave të realizuara me anëtarë të KEPTSH-it, gjatë vlerësimit të teksteve për klasën përgatitore, klasën 1, 6 dhe 10 secili recensent/anëtar i komisionit i ka vlerësuar të gjitha aspektet.

Një paqartësi tjetër, që nuk rregullohet me UA 18/2018 është nëse vlerësimi i teksteve i dorëzohet KEPTSH-it në mënyrë individuale/nga secili recensent apo në formë të një vlerësimi përmbledhës të komisionit. Kjo çështje është e rregulluar me UA 5/2011 zbatimi i standardeve për tekstet shkollore, në të cilin ofrohet formulari përmbledhës për vlerësimin e tekstit shkollor nga komisioni recensues²⁹. Në kuadër të udhëzimeve për punën konkrete me standardet, parashihet plotësimi i formularit përmbledhës nga ekspertët që kanë vlerësuar tekstin³⁰. Sipas intervistave të realizuara me anëtarë të KEPTSH-it, gjatë vlerësimit të teksteve për klasën përgatitore, klasën 1, 6 dhe 10, nga recensentët është kërkuar që raportet e vlerësimit t'i dorëzojnë në mënyrë individuale. Një qasje e tillë është e mundur të jetë aplikuar për shmangien e ndonjë favorizimi eventual nga ana e komisioneve vlerësuese, por kjo përbën shmangie nga procedurat e përcaktuara për këtë proces. Për më shumë, ajo zhvesh nga përgjegjësia recensentët individual pasi që vlerësimin përmbledhës në emër të komisionit e kryen KEPTSH-i.

25 Po aty, neni 4.

26 Po aty, neni 8, paragrafi 1, 2, 3.

27 Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2011 Zbatimi i standardeve për tekstet shkollore (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/standaret-e-teksteve.pdf>).

28 P.sh. Pedagogu/psikologu aspektet didaktike, metodike dhe pedagogjike, gjuhëtari aspektet gjuhësore apo punonjësi shkencor, aspektet shkencore.

29 Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2011 Zbatimi i standardeve për tekstet shkollore (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/standaret-e-teksteve.pdf>), fq.76.


30 Po aty, pika (f), fq. 10.

5. Cilësia e teksteve shkollore në arsimin parauniversitar

Cilësia e teksteve shkollore që aktualisht janë në përdorim është vlerësuar nga perspektiva e mësimeve të cilët punojnë me këto tekste. Në kuadër të fokus grupeve të organizuara, mësuesit fillimisht kanë bërë një vlerësim individual të teksteve me të cilat punojnë për të vazhduar me diskutim të përbashkët rreth shqetësimeve kryesore që ata i kanë në raport me tekstet shkollore³¹.


PËRBËRJA E FOKUS GRUPEVE, SIPAS NIVELIT ARSIMOR DHE LËNDËVE, ËSHTË PËRMBLËDHUR NË TABELËN VIJUESE:

Niveli fillor



Numri i mësuesve


3



Lëndët


N/A

Niveli i mesëm i ulët



Numri i mësuesve


24



Lëndët


Gjuhë shqipe, gjuhë angleze, matematikë, edukatë qytetare, histori, gjeografi, fizikë, kimi, biologji, teknologji

Niveli i mesëm i lartë



Numri i mësuesve

14



Lëndët

Gjuhë shqipe, gjuhë angleze, matematikë, histori, sociologji, filozofi, fizikë, kimi, biologji, TIK

31 Përmes një pyetësi të aplikuar për këtë qëllim, shih Shtojca: 5.

Vlerësimi nuk është përqendruar në tekste specifike dhe trajtimin e thelluar të mangësive të caktuara, por një reflektim të përgjithshëm të përshtypjeve të mësimitdhënësve për tekstet me të cilat punojnë³². Vlerësimi i teksteve shkollore është përqendruar në katër aspektet si në vijim:

- Përmbajtja e teksteve shkollore;
- Aspektet didaktiko-metodike;
- Gjuha, struktura dhe organizimi i përmbajtjes;
- Faqësja dhe ilustrimet.

5.1 Vlerësimi i përmbajtjes së teksteve shkollore

Sa përket përmbajtjes së teksteve shkollore, ajo duhet të jetë e mjaftueshme dhe e plotë për të mundësuar arritjen e rezultateve të të nxëniet të përcaktuara me kurrikulën bërthamë, pa pasur nevojë të shfrytëzohen materiale shtesë. Elementet themelore të kurrikulës duhet të jenë të përfshira, duke siguruar baraspeshë të duhur të thellësisë dhe gjerësisë së temave që trajtohen, por edhe duke e përshtatur nivelin e vështirësisë me kërkesat e kurrikulës bërthamë dhe moshën e nxënësve³³. Konceptet duhet të jenë të qarta dhe të sakta, të shoqëruara me shembuj dhe ilustrime të mjaftueshme, cilësore, funksionale dhe interesante për nxënësit. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe njohurive dhe përvojës paraprake të nxënësve si dhe koherencës në prezantimin e temave dhe koncepteve, por duke iu shmangur përsëritjeve të panevojshme.

Sa i përket përmbajtjes së teksteve shkollore, një numër shumë i vogël i kriterëve të cilësisë është vlerësuar pozitivisht. Aspektet më të ndjeshme në kuadër të kriterëve për cilësinë e përmbajtjes, të evidentuara përmes pyetësorëve të plotësuar nga mësimitdhënësit dhe nga diskutimet në fokus grupe, janë përmbledhur si në vijim:

- Mungesa e relevancës së përmbajtjes për arritjen e rezultateve të të nxëniet të përcaktuara me kurrikulat bërthamë – 10% e mësimitdhënësve konsiderojnë se përmbajtja nuk është aktuale dhe relevante për arritjen e rezultateve të të nxëniet të përcaktuara me kurrikulën bërthamë, 88% konsiderojnë se ky kriter përmbushet pjesërisht, ndërsa vetëm 2% konsiderojnë se ky kriter plotësohet nga tekstet shkollore;
- Mungesa e referencës në burimet e informacionit – 17% e mësimitdhënësve vlerësojnë se burimet e informacionit nuk referohen në mënyrë adekuate, 66% konsiderojnë se ky kriter plotësohet pjesërisht, ndërsa 27% vlerësojnë se tekstet shkollore e plotësojnë këtë kriter;

32 Mësimitdhënësit e ciklit fillor kanë reflektuar në mënyrë të përgjithshme për të gjitha tekstet e këtij niveli, mësimitdhënësit e nivelit të mesëm të ulët apo të lartë kanë reflektuar për tekstet në të gjitha klasët që mbulohen prej tyre.

33 Kjo nuk përjashton mundësinë që mësimitdhënësit të shfrytëzojnë burime shtesë, por ato vijnë në shprehje për të zgjeruar informacionin për temën përkatëse (a) nga ana e mësimitdhënësit (konform interesave të nxënësve-nëse gjithë klasa shpreh interesim të shtuar për temën, apo konform nevojës së komunitetit në të cilin vepron shkolla), apo (b) për lexim shtesë nga nxënësit e veçantë të cilët kanë interesim për temën përkatëse. Për këtë qëllim, për çdo temë të trajtuar duhet të ofrohen edhe burime relevante për lexim të mëtejshëm.

- Konceptet nuk janë gjithnjë të sakta dhe idetë nuk janë koherente. Shembujt dhe ilustrimet nuk janë interesante dhe relevante për përvojat e nxënësve – 22% e mësimitdhënësve vlerësojnë se konceptet janë të sakta dhe precise dhe se ilustrimet janë të mjaftueshme, interesante dhe relevante për nevojat e nxënësve, 68% vlerësojnë se ky kriter plotësohet pjesërisht, ndërsa vetëm 10% konsiderojnë se këtë kriter e plotësojnë tekstet shkollorë;
- Konceptet e reja nuk prezantohen në mënyrë adekuate, në momentin dhe mënyrën e duhur si dhe ndërlidhja me njohuritë paraprake të nxënësve është e pamjaftueshme - 5% konsiderojnë se tekstet nuk e përmbushin këtë kriter, 78% vlerësojnë se ky kriter përmbushet pjesërisht, ndërsa 17% konsiderojnë se këtë kriter e përmbushin tekstet shkollorë;
- Niveli i vështirësisë nuk i përshtatet nivelit kognitiv të nxënësve dhe kërkesave kurrikulare – 24% e mësimitdhënësve janë deklaruar se niveli i vështirësisë nuk i përshtatet nivelit kognitiv dhe kërkesave kurrikulare, 56% konsiderojnë se ky kriter përmbushet pjesërisht, ndërsa 20% vlerësojnë se këtë kriter e përmbushin tekstet shkollorë;
- Përmbajtja e tepërt, që nuk është në funksion të drejtpërdrejtë të arritjes së rezultateve të të nxënësve – 41% e mësimitdhënësve janë deklaruar se këtë kriter nuk e përmbushin tekstet shkollorë, 39% konsiderojnë se ky kriter përmbushet pjesërisht dhe vetëm 12% prej tyre konsiderojnë se këtë kriter e përmbushin tekstet shkollorë;

Për më shumë, mangësi tjera të identifikuar gjatë fokus grupeve me mësimitdhënës përfshijnë edhe aspektet e mëposhtme:

- Tekstet janë në shpërputhje të madhe me kurrikulën dhe programin mësimor (p.sh. deri në 50% në tekstet e historisë për gjimnaz, apo rreth 40% në tekstet e gjeografisë për nivelin e mesëm të ulët);
- Gabimet shkencore janë të pranishme;
- Përmbajtja nuk është aktuale, e papërditësuar dhe e stërngarkuar me tekst, fakte, shifra, formula dhe detyra;
- Mungesë e të dhënave të mjaftueshme për një çështje të caktuar dhe trajtim shumë sipërfaqësor i temave të rëndësishme;
- Niveli i vështirësisë nuk i përshtatet nivelit kognitiv të nxënësve;
- Radhitja e njësive mësimore shpesh nuk është adekuate;
- Korrelacioni ndër-lëndor shpesh mungon, duke pamundësuar jo vetëm qasjen e integruar por edhe realizimin e njësive të caktuara mësimore, në mungesë të informatave paraprake që është dashur të përvetësohen në kuadër të lëndës tjetër;

- Mungesa e përputhshmërisë me tekstet e lëndës së njëjtë në klasat pararendëse apo/dhe pasuese, në veçanti në tekstet e lëndës së historisë;
- Raste kur pjesë të përmbajtjes përsëriten nga klasa në klasë, për dy-tre vite radhazi, pa asnjë ndryshim (p.sh. në tekstin e gjuhës shqipe për nivelin e mesëm të ulët apo tekstin e sociologjisë për gjimnaze);
- Shembujt nuk janë relevant për jetën dhe përditshmërinë e nxënësve.

5.2 Vlerësimi i aspekteve didaktiko-metodike

Aspektet didaktike dhe metodike duhet të sigurojnë zhvillimin e kompetencave kryesore dhe arritjen e rezultateve të të nxënësve për fushën përkatëse kurrikulare, duke i përfshirë nxënësit në aktivitete të ndryshme të të nxënësve dhe duke i ndihmuar ata që të aftësohen për të mësuar. Në këtë kontekst, teksti shkollor duhet të përmbajë:

- Aktivitete që i motivojnë nxënësit për të mësuar;
- Mundësi për përpunim të thelluar të informacionit, për zhvillim të të menduarit kritik dhe kreativ duke i nxitur dhe përfshirë nxënësit përmes pyetjeve të hapura dhe referencave për lexim të mëtutjeshëm;
- Aktivitete që iu mundësojnë nxënësve që në mënyrë aktive të integrojnë, praktikojnë dhe zbatojnë dijen e re;
- Përmbajtje dhe aktivitete që kultivojnë vlerat dhe qëndrimet pozitive;
- Aktivitete/detyra që mundësojnë qasje të ndryshme të të nxënësve;

Aspektet më të ndryshme në kuadër të aspektit didaktik-metodik, të evidentuara përmes pyetësorëve të plotësuar nga mësuesit dhe nga diskutimet në fokus grupe, janë përmbledhur si në vijim:

- Tekstet nuk i kushtojnë vëmendjen e nevojshme zhvillimit të shkathtësive të larta intelektuale - 18% e mësuesve vlerësojnë se tekstet nuk mundësojnë zhvillim të shkathtësive kognitive në të gjitha nivelet, 70% vlerësojnë se ky kriter përmbushet vetëm pjesërisht, ndërsa vetëm 12% konsiderojnë se këtë kriter e përmbushin tekstet shkollore;
- Përmbajtja nuk mund të shfrytëzohet në mënyrë fleksibile, konform aftësive dhe stileve të ndryshme të të nxënësve - 14% e mësuesve vlerësojnë se përmbajtja e njësive mësimore nuk është e organizuar në pjesë të përshtatshme, të pavarura ose me ndërlikime fleksibile për të mundësuar shfrytëzim fleksibil konform aftësive dhe stileve të ndryshme të të nxënësve, 70% vlerësojnë se ky kriter përmbushet vetëm pjesërisht, ndërsa 16% konsiderojnë se këtë kriter e përmbushin tekstet shkollore;

- Aktivitetet e nxënies nuk u mundësojnë nxënësve që në mënyrë aktive të integrojnë, praktikojnë dhe zbatojnë dijen e re – 22% e mësimitdhënësve vlerësojnë se aktivitetet e nxënies nuk iu mundësojnë nxënësve që në mënyrë aktive të integrojnë, praktikojnë dhe zbatojnë dijen e re, 64% vlerësojnë se ky kriter përmbushet vetëm pjesërisht, ndërsa 14% konsiderojnë se këtë kriter e përmbushin tekstet shkollore;
- Aktivitetet e nxënies nuk janë interesante dhe nuk i motivojnë nxënësit për të mësuar – 23% e mësimitdhënësve konsiderojnë se aktivitetet e nxënies nuk janë interesante dhe nuk i motivojnë nxënësit për të mësuar, 63% konsiderojnë se ky kriter përmbushet pjesërisht dhe 13% konsiderojnë se këtë kriter e plotësojnë tekstet shkollore;
- Detyrat/kërkesat nuk mundësojnë qasje të ndryshme të të nxëniet – 22% e mësimitdhënësve konsiderojnë se aktivitetet mundësojnë qasje të ndryshme të të nxëniet, 63% konsiderojnë se ky kriter përmbushet pjesërisht dhe 15% konsiderojnë se këtë kriter e plotësojnë tekstet shkollore;
- Teksti nuk mund të përdoret në mënyrë të pavarur nga nxënësi, ashtu që të arrijë të kuptojë rezultatet e njësive mësimore, të bëjë vetë-vlerësim dhe të planifikojë të nxëniet e mëtutjeshëm – 23% e mësimitdhënësve konsiderojnë se aktivitetet e nxënies nuk iu mundësojnë nxënësve të kuptojnë qëllimet kryesore të njësive mësimore, të vetë-vlerësojnë atë që kanë mësuar dhe të planifikojnë nxënien e tyre, 63% konsiderojnë se ky kriter përmbushet pjesërisht dhe 14% konsiderojnë se këtë kriter e plotësojnë tekstet shkollore.

Për më shumë, mangësi tjera të identifikuar gjatë fokus grupeve me mësimitdhënës përfshijnë edhe aspektet e mëposhtme:

- Tekstet nuk mundësojnë përfshirjen aktive të nxënësve në procesin e të nxëniet;
- Detyrat shpesh nuk korrespondojnë me tekstin bazë, si dhe mungojnë burimet për lexim shtesë;
- Detyrat për nivelin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë nuk ofrohen në fund të çdo njësive mësimore, por në fund të kapitujve;
- Detyrat nuk mundësojnë llojllojshmëri përgjigjesh;
- Detyrat në kuadër të shkencave të natyrës nuk ofrojnë mundësi për realizim në kushte shtëpie me materiale nga jeta e përditshme (supozojnë punë laboratorike).

5.3 Vlerësimi i gjuhës, strukturës dhe organizimit të përmbajtjes

Gjuha e përdorur në tekstet shkollore, pavarësisht lëndës duhet t'i kontribuoj zhvillimit gjuhësor të nxënësve, dhe si e tillë kërkon vëmendje të veçantë. Po ashtu, gjuha duhet të mundësoj procesimin e të dhënave prandaj edhe duhet t'i përshtatet nivelit zhvillimor të nxënësve si dhe të jetë e kapshme dhe interesante për ata.

Nga ana tjetër, struktura dhe organizimi i duhur i përmbajtjes në tekstin shkollor duhet t'i mundësoj nxënësit që të orientohen më lehtë dhe të shfrytëzojnë tekstin në mënyrë të pavarur. Rezultatet e pritura në fillim të çdo njësie dhe kriteret e suksesit në fund të secilës njësi mësimore, iu mundësojnë nxënësve që të vetëreflektojnë dhe të përfshihen në planifikimin e të nxënësve.

Në vijim janë përmbledhur disa nga aspektet më të ndjeshme në kuadër të aspektit të gjuhës, strukturës dhe organizimit të përmbajtjes, të evidentuara përmes pyetësorëve të plotësuar nga mësimdhënësit dhe nga diskutimet në fokus grupe.

- Gjuha e përdorur nuk është interesante për nxënësit – 10% e mësimdhënësve vlerësojnë se gjuha e përdorur në tekste shkollore nuk është e kapshme dhe interesante për nxënësit, 67% konsiderojnë se ky kriter përmbushet vetëm pjesërisht ndërsa 23% konsiderojnë se këtë kriter e përmbushin tekste shkollore;
- Ndarja e njësive mësimore nuk është e përshtatshme dhe logjike – 14% e mësimdhënësve vlerësojnë se ndarja e njësive nuk është e përshtatshme dhe logjike, 62% konsiderojnë se ky kriter përmbushet vetëm pjesërisht ndërsa 24% konsiderojnë se tekste shkollore e përmbushin këtë kriter;
- Rezultatet e të nxënësve nuk ofrohen në fillim të njësive mësimore dhe as kriteret e suksesit në fund të tyre – 59% e mësimdhënësve deklarojnë se rezultatet e pritura nuk ofrohen në fillim të çdo njësie dhe as kriteret e suksesit në fund të tyre, 34% deklarojnë se ky kriter përmbushet vetëm pjesërisht ndërsa vetëm 7% konsiderojnë se këtë kriter e përmbushin tekste shkollore.

Për më shumë, mangësi tjera të identifikuar gjatë fokus grupeve me mësimdhënësit përfshijnë edhe aspektet e mëposhtme:

- Gjuha e përdorur është shumë akademike dhe e thatë dhe ka raste kur pjesë të përmbajtjes në lëndën e matematikës janë plotësisht të ngjashme/të njëjta me përmbajtjen në tekstin universitar;
- Dominojnë terma dhe koncepte shumë abstrakte dhe të ndërlikuara;
- Teksti shpesh përmban gabime ortografike dhe drejtshkrimore dhe lidhja sintaksore e fjalëve në fjali shpesh ka mangësi.

5.4 Vlerësimi i faqesjes dhe ilustrimeve

Sa i përket faqesjes dhe ilustrimeve, përmbajtja e teksteve shkollore duhet të jetë e organizuar mirë, duke shfrytëzuar në mënyrë të duhur hapësirën dhe margjinat, për të lehtësuar leximin. Ilustrimet adekuate duhet ta ndihmojnë nxënësin të përqendrohet në temën përkatëse dhe jo të kundërtën. Ilustrimet nuk duhet të shërbejnë për dekor por për plotësim të informacionit të ofruar përmes tekstit.

Në kuadër të kriterëve për këtë aspekt, edhe pesha e librit është e një rëndësie të veçantë, sidomos tek ne ku shqetësimi për peshën e çantave të nxënësve është i madh. Nisur nga kjo, shfrytëzimi i letres me peshë të vogël, por edhe ndarja e teksteve shkollorë në vëllime më të vogla (p.sh. për çdo gjysmëvjetor) do të duhej të parashihej në kriteret për shtëpitë botuese.

Aspektet më të ndjeshme në kuadër të kriterëve për këtë aspekt, sipas mësimdhënësve të përfshirë në fokus grupe, janë përmbledhur si në vijim.

- Organizimi joadekuat i materialit, për të lehtësuar nxënien – 13% konsiderojnë se materiali nuk është i organizuar mirë për të lehtësuar nxënien, 72% vlerësojnë se ky kriter plotësohet vetëm pjesërisht ndërsa 15% konsiderojnë se tekstet shkollorë e përmbushin këtë kriter;
- Ilustrimet jo adekuate, jo cilësore dhe të papërshtatshme për ta nxitur dhe lehtësuar nxënien – 24% konsiderojnë se ilustrimet nuk janë adekuate, cilësore dhe të përshtatshme për të stimuluar dhe lehtësuar nxënien, 67% vlerësojnë se ky kriter plotësohet vetëm pjesërisht ndërsa vetëm 9% konsiderojnë se tekstet shkollorë e përmbushin këtë kriter.

Për më shumë, shqetësues kryesor është fakti se 40 nga 41 mësimdhënësit e përfshirë në fokus grupe nuk janë të kënaqur me tekstet shkollorë³⁴. Arsytimi se tekstet që aktualisht janë në përdorim i referohen kurrikulës që ka qenë në zbatim deri në vitin 2017/2018 nuk qëndron, pasi që shumica e kriterëve, në bazë të së cilave është realizuar ky vlerësim, vlejnë edhe për kurrikulën paraprake.

Cilësia e teksteve shkollorë përbën edhe një shqetësim të përgjithshëm shoqëror, që shpesh është adresuar edhe nga mediat. Në këtë drejtim, në vitin 2010 Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) ka publikuar raportin “Problemet dhe të metat e teksteve shkollorë - Analizë e teksteve shkollorë të Kosovës të ciklit të shkollës së mesme të ulët (klasët VI, VII, VIII, IX)”, i cili përmban një analizë të hollësishme të teksteve të shkencave shoqërore dhe natyrore të nivelit të mesëm të ulët, me përqendrim në saktësinë shkencore, ngarkesën, mendimin kritik, metodat bashkëkohore të mësimdhënies, aspektet didaktiko-metodike, aspektet gjinore dhe aspektet përmbajtësore³⁵.

Në vitin 2013, BIRN publikoi raportin në të cilin rishqyrton çështjet e ngritura në vitin 2010, për të konstatuar progresin e shënuar në këtë drejtim³⁶. Rezultatet e këtij rishqyrtimi tregojnë se pjesa më e madhe e lëshimeve të evidentuara në raportin e vitit 2010 nuk janë përmirësuar me rastin e ribotimeve të teksteve shkollorë. Marrë parasysh faktin se vërejtjet në studimin e vitit 2010 nuk i janë referuar kërkesave për avancim të cilësisë por përmbushjes së kriterëve bazike për tekstet shkollorë, injorimi i tyre është i papranueshëm.

34 Përjashtim ishin tekstet shkollorë dhe materialet mësimore për gjuhën angleze nga PEARSON.

35 Problemet dhe të metat e teksteve shkollorë-Analizë e teksteve shkollorë të Kosovës të ciklit të shkollës së mesme të ulët (klasët VI, VII, VIII, IX), BIRN, Prishtinë, 2010.

36 Problemet dhe të metat e teksteve shkollorë-Analizë e teksteve shkollorë të Kosovës të ciklit të shkollës së mesme të ulët (klasët VI, VII, VIII, IX)- rishqyrtim i çështjeve të ngritura në studimin e vitit 2010, BIRN, Prishtinë, 2013.

6. Përfundimet dhe rekomandime

Për të siguruar koherencën dhe konsistencën e procesit të zbatimit të qasjes së bazuar në kompetenca, Korniza Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar vendos pesë parime themelore të cilat duhet të udhëheqin gjithë procesin e zbatimit të reformës kurrikulare. Si të tilla, këto parime duhet të udhëheqin edhe procesin e përgatitjes dhe miratimit të teksteve shkollore dhe materialeve të tjera mësimore. Megjithatë, nga analiza e kuadrit ligjor dhe mekanizmave institucional për hartimin, vlerësimin, miratimin dhe botimin e teksteve shkollore rezultoi se implikimet e këtyre parimeve në dokumentet përkatëse nuk janë reflektuar mjaftueshëm.

Mangësitë kryesore në kuadrin ligjor, në bazë të të cilit janë duke u hartuar dhe vlerësuar tekstet e reja, përfshijnë:

- Mungesa e përputhshmërisë ndërmjet dokumenteve që rregullojnë procesin e hartimit, vlerësimit dhe miratimit të teksteve shkollore dhe materialeve mësimore;
- Mangësi në trajtimin e aspekteve themelore që rregullojnë këto procese dhe paqartësi të shumta procedurale;
- Shmangia e masave të rëndësishme në procesin e përgatitjeve për hartimin e teksteve të reja dhe në procesin e vlerësimit të tyre;
- Moskonsolidimi i mekanizmave për mbledhjen e vazhdueshme të të dhënave nga shkollat/komunat lidhur me cilësinë e teksteve shkollore.

Në fazat e para të pilotimit të kurrikulës së re dhe pas shtrirjes së zbatimit në mbarë vendin, përkundër mungesës së teksteve të reja, shkollat nuk kanë pranuar asnjë udhëzues të veçantë se si duhet ti qasen shfrytëzimit të teksteve aktuale konform frymës së re të kurrikulës. Orientimet e ofruara në kurrikulat bërthamë janë shumë të përgjithshme, me theks në mundësinë e shfrytëzimit të teksteve dhe materialeve alternative, por nuk iu ndihmojnë mësimdhënësve që të ri-pozicionohen në raport me tekstet shkollore. Situata është e ngjashme edhe në kurrikulat lëndore/programet mësimore të përgatitura për klasën përgatitore, klasën e parë, të dytë, të gjashtë, të shtatë, të dhjetë dhe të njëmbëdhjetë. Përveç kësaj, as në kuadër të programeve të trajnimit të mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës së re, kësaj çështjeje nuk i është kushtuar vëmendja e duhur.

Nga ana tjetër, gjatë periudhës së pilotimit të kurrikulës së re ka munguar mekanizmi për evidentimin e të dhënave nga shkollat/komunat lidhur me mangësitë e teksteve shkollore nga këndvështrimi i kërkesave të reja të kurrikulës. Një evidentim i tillë i mangësive tipike dhe të përsëritura nga mësimdhënësit, të cilët kanë punuar me tekstet ekzistuese në zbatimin e kurrikulës së re, do t'i kontribuonte shumë hartimit të politikave të duhura për hartimin, vlerësimin, miratimin dhe botimin e teksteve të reja.

Sa i përket cilësisë së teksteve shkollore që aktualisht janë në përdorim, shqetësimet kryesore të mësimdhënësve përfshijnë:

- Mungesën e aktualitetit, relevancës dhe përputhshmërisë me kurrikulën e re;
- Mbingarkesën me tema, tekst, fakte dhe formula;
- Përmbajtje të fakteve të pasakta dhe koncepteve të padefinuara mirë;
- Mungesë të baraspeshës në gjerësinë dhe thellësinë e trajtimit të temave;
- Mungesë të perspektivës së shumëfishtë në trajtimin e temave;
- Strukturim të papërshtatshëm dhe jokonsistent të përmbajtjes;
- Mungesë e referencës në burime të tjera për informata shtesë;
- Mospërshtatje me nivelin kognitiv të nxënësve;
- Mungesë e mundësisë për tu ndërlidhur me informatat dhe përvojat paraprake të nxënësve;
- Mungesë e korrelacionit ndër-kurrikular;
- Mungesë e rezultateve të pritura në fillim të çdo njësie/teme mësimore dhe kritereve të suksesit në fund të secilës njësi;
- Pamundësi për shfrytëzim fleksibil të tekstit, konform aftësive dhe qasjeve të ndryshme të të nxënësve;
- Përqendrim në informata/fakte dhe reproduktim;
- Ilustrime jo adekuate, jo funksionale dhe jo atraktive për nxënësin.

Bazuar në shqetësimet e lartcekura të mësimdhënësve, por edhe bazuar në raportet tjera që trajtojnë tekstet shkollore, standardet dhe treguesit për vlerësimin e teksteve shkollore do të duhej të rishikohen duke siguruar që mangësitë e lartpërmendura të kenë vëmendjen e duhur.

Përgatitja e udhëzuesve përkatës për botuesit/autorët e teksteve shkollore mbi implikimet e parimeve të Kornizës kurrikulare në tekstet shkollore dhe planifikimi i programeve të trajnimit për ta është po ashtu e domosdoshme.

Nga ana tjetër, kuadri institucional dhe ligjor për hartimin, vlerësimin, miratimin dhe botimin e teksteve shkollore duhet të plotësohet dhe harmonizohet në mënyrë që të jetë në funksion të ngritjes së cilësisë të teksteve shkollore, përfshirë:

- Përcaktim më të qartë të rolit dhe përbërjes së KEPTSH, konform pritshmërive nga ky organ; praktika të mira të funksionimit të këtij organi sugjerojnë përfaqësim më të madh të fushave kurrikulare;
- Përcaktim më të qartë të procesit dhe përgjegjësisë të shkollave, DKA-ve, KEPTSH-it dhe MASHT-it në procesin e përzgjedhjes dhe porosisë së teksteve shkollore të cilat financohen nga MASHT;
- Përcaktim më të qartë të procesit të tërheqjes së teksteve dhe materialeve mësimore nga përdorimi; përmirësim i mangësive eventuale apo edhe avancimi i vazhdueshëm i cilësisë së tyre; vendosja e një mekanizmi për mbledhjen e vazhdueshme të të dhënave nga shkollat/komunat lidhur me cilësinë e teksteve shkollore;
- Përcaktim më të qartë të procesit të vlerësimit të teksteve shkollore nga ekipi i recensentëve;
- Përcaktim më të qartë të rolit të recensentëve, afatit kohor dhe procedurave të vlerësimit përfundimtar të dorëshkrimeve të rishikuara nga shtëpitë botuese (në bazë të rekomandimeve të recensentëve);
- Përcaktim të procesit të testimit të teksteve shkollore në shkolla;
- Shqyrtimi i mundësive të përkthimit dhe përshtatjes së teksteve nga vendet tjera.

Po ashtu, koordinimi ndërmjet MASHT-it, DKA-ve, shkollave dhe shtëpive botuese duhet të fuqizohet duke siguruar që burimet ekzistuese të shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe efiqente për përmirësimin e dizajnit, prodhimit dhe shpërndarjes së teksteve shkollore dhe materialeve tjera mësimore.

Shtojcat

Shtojca 1: Lista e dokumenteve të shqyrtuara

- 1 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (2018), Ftesë për shprehje interesi për recensentë për vlerësimin e dorëshkrimeve për klasat 0, 1, 6 dhe 10 të pranuar në MASHT në bazë të konkursit të shpallur me datën 20 prill 2018 dhe të plotësuar me datën 24 korrik 2018 (<https://masht.rks-gov.net/konkurset>).
- 2 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2018). Udhëzimi Administrativ nr. 18/2018 për recensentët, vlerësimin dhe lejimin e teksteve shkollore dhe materialeve mësimore (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/12/ua-nr-18-18-per-recensentet-vleresimin-dhe-lejmin-e-teksteve-shkollore-dhe-mat-shkollor-x.pdf>).
- 3 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2018). Vendimi nr. 251/01B për emërimin e Këshillit të ekspertëve për programe dhe tekste shkollore.
- 4 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2018). Rregullore - Këshilli i ekspertëve për programe dhe tekste shkollore.
- 5 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/ Programet mësimore, Klasa përgatitore (<https://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>).
- 6 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/ Programet mësimore, Klasa e parë (<https://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>).
- 7 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/ Programet mësimore, Klasa e dytë (<https://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>).
- 8 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/ Programet mësimore, Klasa e gjashtë (<https://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>).
- 9 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/Programet mësimore, Klasa e shtatë (<https://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>).

- 10 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/ Programet mësimore, Klasa e dhjetë (<https://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>).
- 11 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2018). Kurrikulat lëndore/ Programet mësimore, Klasa e njëmbëdhjetë (<https://masht.rks-gov.net/arsimi-parauniversitar>).
- 12 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2016). Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021 (https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/20161006-psak-2017-2021_1.pdf).
- 13 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2016). Udhërrëfyes për zbatimin e kurrikulës së re 2016-2021 (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/03/udherrefyes-per-zbatimin-e-kk-2016-2021-final.pdf>).
- 14 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2016). Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-kurrikulare-finale.pdf>).
- 15 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2016). Kurrikula Bërthamë për Klasën Përgatitore dhe Arsimin Fillor të Kosovës (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/kurrikula-berthame-1-finale-2.pdf>).
- 16 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2016). Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët të Kosovës (https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-berthame-2-final_1.pdf).
- 17 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2016). Kurrikula Bërthamë për Arsimin e Mesëm të Lartë të Kosovës (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/02/korniza-berthame-3-final.pdf>).
- 18 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2016). Udhëzimi Administrativ nr. 22/2016 për Aktivet Profesionale (Departamentet) të Shkollave (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2016/12/22-ua-nr-22-2016-per-aktivitetet-profesionale-te-shkollave.pdf>).
- 19 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2011). Udhëzimi Administrativ nr. 05/2011 Zbatimi i standardeve për tekstet shkollore (<https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/05/standardet-e-teksteve.pdf>).
- 20 Ligji Nr.02/L-67 për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik (<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2437>).

Shtojca 2: Lista e zyrtarëve/ekspertëve të intervistuar

- 1 Selim Mehmeti, IPK (15 shkurt 2019)
- 2 Ismet Potera, IPK (22 shkurt 2019)
- 3 Hajrie Devetaku-Gojani- ish recensente dhe pjesë e Grupit Punues për Hartimin e Standardeve për Tekstet Shkollore (26 shkurt 2019)
- 4 Feime Llapashtica Lipscomb, MASHT- Divizioni për Plan Programe dhe Tekste Shkollore dhe anëtare e KEPTSH (27 shkurt 2019)
- 5 Arbër Salihu, MASHT-Divizioni për Plan Programe dhe Tekste Shkollore (27 shkurt 2019)
- 6 Rrezearta Zhinipotoku-Behluli – GIZ CDBE (4 mars 2019)
- 7 Osman Buleshkaj (22 mars 2019)

Shtojca 3: Lista e mësimdhënësve pjesëmarrës në fokus grupe

Arsimi fillor

	Emri dhe mbiemri	Institucioni arsimor	Komuna	Lënda mësimore
1	Antonije Bytyqi	“Zekeria Rexha”	Gjakovë	Mësimdhënëse e mësimit klasor
2	Trendelina Berisha	“Xhemajl Mustafa”	Prishtinë	Mësimdhënëse e mësimit klasor
3	Vllaznim Balidema	“Mileniumi III”	Prishtinë	Mësimdhënës i mësimit klasor

Arsimi i mesëm i ulët

	Emri dhe mbiemri	Institucioni arsimor	Komuna	Lënda mësimore
1	Kosovare Makolli	“Faik Konica”	Prishtinë	Fizikë
2	Fatmir Latifi	“Mulla Idriz Gjilani”	Gjilan	Gjuhë dhe letërsi shqipe
3	Maliqe Syla	“Gjergj Fishta”	Prishtinë	Gjuhë dhe letërsi shqipe
4	Shpetim Kastrati	“Mileniumi III”	Prishtinë	Kimi
5	Rukije Krasniqi	“Isa Boletini”	Rahovec	Biologji
6	Fellanza Kerajtani	“Emin Duraku”	Prizren	Histori
7	Fatmire Tmava	“Gjergj Fishta”	Prishtinë	Gjuhë angleze
8	Azemine Sadiku	“Ibrahim Rugova”	Obiliq	Biologji
9	Ekrem Feka	“Anton Zako Cajupi”	Vushtrri	Fizikë
10	Driton Sadiku	“Ismail Luma”	Lipjan	Biologji
11	Lirie Gegaj	“Qamil Batalli”	Prishtinë	Fizikë
12	Xhemajl Halili	“Qamil Batalli”	Prishtinë	Edukatë qytetare
13	Aida Stublla	“Yll Morina”	Gjakovë	Teknologji
14	Leonora Luta	“Yll Morina”	Gjakovë	Biologji
15	Arjeta Hajdaraga	“Emin Duraku”	Gjakovë	Matematikë
16	Skender Halimi	“Ilmi Rakovica”	Prishtinë	Gjeografi

	Emri dhe mbiemri	Institucioni arsimor	Komuna	Lënda mësimore
17	Krenare Basha	“Pjetër Bogdani”	Prishtinë	Gjuhë angleze
18	Besim Haliti	“Kuvendi i Lezhës”	Viti	Histori
19	Selvete Krasniqi	“Ganimete Tërbeshi”	Prishtinë	Kimi
20	Ganimete Pacolli	“Ganimete Tërbeshi”	Prishtinë	Edukatë qytetare
21	Ibe Gashi	“Faik Konica”	Prishtinë	Matematikë
22	Supije Zhitija	“Gjergj Fishta”	Prishtinë	Matematikë
23	Arbënor Pozhegu	“Mazllum Këpuska”	Gjakovë	Gjeografi
24	Dhurata Bejtullahu	“Zekeria Rexha”	Gjakovë	Gjuhë shqipe

Arsimi i mesëm i lartë - Gjinnazet

	Emri dhe mbiemri	Institucioni arsimor	Komuna	Lënda mësimore
1	Havushe Ahmeti	“Xhevdet Doda”	Prishtinë	Fizikë
2	Blerina Hoxha	“Xhevdet Doda”	Prishtinë	Biologji
3	Teutë Blakaj	“Xhevdet Doda”	Prishtinë	Biologji
4	Pranvera Misini	“Xhevdet Doda”	Prishtinë	Teknologji
5	Ajshe Metaj	“Haxhi Zeka”	Istog	Kimi
6	Ndrec Perlleshi	“Gjon Nikolle Kazazi”	Gjakovë	Histori
7	Halim Halimi	“Hivzi Sylejmani”	Fushë Kosovë	Filozofi-Sociologji
8	Kujtim Baraliu	“Gjon Buzuku”	Prizren	Fizikë
9	Besnik Krasniqi	“Gjon Buzuku”	Prizren	Gjuhë shqipe
10	Hamdi Fazliu	“Gjon Buzuku”	Prizren	Histori
11	Zojë Berisha	“Hivzi Sylejmani”	Fushë Kosovë	Gjuhë Angleze
12	Yllka Kusari-Radoniqi	“Prek Jakova”	Gjakovë	TIK
13	Festim Shkodra	“Xhavit Ahmeti”	Gjilan	Matematikë
14	Ismajl Zuzaku	“Xhavit Ahmeti”	Gjilan	Kimi

Shtojca 4: Përmbledhjet e diskutimeve nga fokus grupet

FOKUS GRUPI I PARË ME MËSIMDHËNËS

Datë: 21/03/2019

Koha: 10.00-12.00

Qëllimi i takimit: Diskutim për cilësinë e teksteve shkollore nga perspektiva e përshtatjes së tyre me kërkesat dhe parimet e Kornizës Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Kosovë.

Pjesëmarrësit në fokus grup: 8 mësimitdhënës të nivelit të mesëm të ulët nga shkollat “Qamil Batalli” Prishtinë, “Hilmi Rakovica” Prishtinë, “Pjetër Bogdani” Prishtinë, “Gjergj Fishta” Prishtinë, “Yll Morina” Gjakovë dhe “Emin Duraku” Gjakovë³⁷.

Rrjedha e takimit: Në pjesën e parë të takimit, pjesëmarrësit në mënyrë individuale kanë reflektuar perspektivën e tyre për cilësinë e teksteve shkollore me të cilat punojnë aktualisht, në pyetësorët e përgatitur për këtë qëllim.

Në vazhdim diskutimi në fokus grup ka filluar me reflektim mbi aspektet më të ndjeshme të teksteve shkollore (aspektet që ata i kanë vlerësuar si më të dobëtat), sfidat kryesore me të cilat mësimitdhënësit përballen gjatë punës me tekstet shkollore dhe zgjidhjet të cilat ata i aplikojnë.

³⁷ Mësimitdhënës të lëndëve: matematikë, fizikë, biologji, informatikë-teknologji, histori, gjeografi.

Përmbledhje e të dhënave në pyetësorë dhe diskutimeve në fokus grup

Aspektet e vlerësuara	Të dhënat e përmbledhura nga pyetësorët për cilësinë e teksteve shkollore ³⁸	Konkluzionet e diskutimeve
Përmbajtja e teksteve shkollore	<p>Në kuadër të kriterëve që përcaktojnë cilësinë e përmbajtjes së teksteve shkollore, aspektet më të ndjeshme janë vlerësuar të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Mungesa e relevancës së përmbajtjes për arritjen e rezultateve të të nxëniet të përcaktuara me kurrikulat bërthamë; ● Mungesa e referencës në burimet e informacionit; ● Prezantim jo adekuat i koncepteve të reja, në momentin dhe mënyrën e duhur, si dhe ndërlidhje e pamjaftueshme me njohuritë paraprake të nxënësve; ● Mungesa e perspektivës së shumëfishtë në trajtimin e temave; 	<p>Përmbajtja shpesh përmban lëshime/gabime shkencore;</p> <p>Tekstet janë të stërngarkuara me fakte (p.sh. në tekstin e Gjeografisë për klasën IX, në kuadër të çdo njësie ofrohen 12-13 shifra për t'u mbajtur mend);</p> <p>Korrelacioni ndër-lëndor shpesh mungon duke pamundësuar jo vetëm qasjen e integruar por edhe realizimin e njësive të caktuara mësimore-në mungesë të informatave paraprake që është dashur të përvetësohen në kuadër të lëndës tjetër;</p> <p>Mungesa e përputhshmërisë me tekstet e së njëjtës lëndë në klasat pararendëse dhe pasuese, sidomos në tekstet e historisë;</p> <p>Temat kryesore trajtohen në mënyrë shumë sipërfaqësore (hapësirë e pamjaftueshme për temat esenciale).</p>
Mësimdhënia dhe mësimnxënia (aspektet pedagogjike/didaktike)	<p>Pikat më të ndjeshme në kuadër të kësaj komponente janë vlerësuar të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Tekstet nuk i kushtojnë vëmendjen e nevojshme zhvillimit të shkathtësive të larta intelektuale; ● Pamundësia për shfrytëzim fleksibil të përmbajtjeve konform aftësive dhe qasjeve të ndryshme të të nxëniet; ● Mungesa e instruksioneve të qarta për aktivitete; ● Teksti nuk mund të përdoret në mënyrë të pavarur nga nxënësi, në mënyrë që t'i kuptojë rezultatet e njësive mësimore, të bëjë vet-vlerësim dhe të planifikojë të nxëniet e mëtejshëm). 	<p>Tekstet nuk mundësojnë përfshirjen aktive të nxënësve në procesin e të nxëniet.</p>

38 Pyetësorët e plotësuar nga pjesëmarrësit në fokus grup.

Gjuha, struktura dhe organizimi i përmbajtjes	<p>Në kuadër të kësaj komponente, pikat më të ndjeshme janë vlerësuar të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Gjuha e përdorur nuk është interesante për nxënësit; ● Ndarja e njësive mësimore nuk është e përshtatshme dhe logjike; ● Rezultatet e të nxënit nuk ofrohen në fillim të njësive mësimore dhe as kriteret e suksesit në fund të tyre.
Faqosja dhe ilustrimet	Shqetësimi kryesor i mësimdhënësve në kuadër të kësaj komponente i referohet ilustrimeve jo adekuate, jo cilësore dhe të papërshtatshme për ta stimuluar dhe lehtësuar nxënien.

Përrjashtimet: Përrjashtim nga vlerësimi i përrshkruar më lartë bëjnë tekstet e gjuhës angleze (PEARSON) të cilat në masë të madhe përmbushin të gjitha kriteret e cilësisë.

Sfidat: Për shfrytëzimin e teksteve alternative, prindërit nuk janë pajtohen që të blejnë tekste shitesë, përderisa ato sigurohen falas nga MASHT. Në mungesë të pajisjeve teknike në shkolla, mësimdhënësit nuk e kanë të mundur as shtypjen e materialeve plotësuese.

Aspekte të tjera: Disa nga mësimdhënësit pjesëmarrës në fokus grup kanë qenë të përrfshirë, apo e kanë pasur mundësinë të përrfshihen në zhvillimin e teksteve të reja; ata vlerësojnë se koha në dispozicion për këtë proces ka qenë shumë e shkurtër dhe janë skeptik edhe për cilësinë e teksteve të reja.

Në kuadër të trajnimeve të mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës së re, përrgatitjes së tyre për punë me tekste të vjetra nuk i është kushtuar vëmendje e mjaftueshme. Edhe udhëzimet e ofruara në kuadër të kurrikulave bërthamë dhe programeve mësimore i referohen kryesisht rëndësisë së shfrytëzimit të materialeve mësimore dhe burimeve të ndryshme, por nuk përmbajnë orientime konkrete për punë me tekstet e vjetra.

FOKUS GRUPI I DYTË ME MËSIMDHËNËS

Datë: 21/03/2019

Koha: 13.00-15.00

Qëllimi i takimit: Diskutim për cilësinë e teksteve shkollore nga perspektiva e përshtatjes së tyre me kërkesat dhe parimet e Kornizës Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Kosovë.

Pjesëmarrësit në fokus grup: 8 mësime të nivelit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë nga shkollat fillore dhe të mesme të ulëta “Zekeria Rexha” Gjakovë, “Mazllum Këpuska” Gjakovë dhe gjimnazet “Xhevdet Doda” Prishtinë, “Prenk Jakova” Gjakovë dhe “Gjon Buzuku” Prizren³⁹.

Rrjedha e takimit: Në pjesën e parë të takimit, pjesëmarrësit në mënyrë individuale kanë reflektuar perspektivën e tyre për cilësinë e teksteve shkollore me të cilat punojnë aktualisht, në pyetësorët e përgatitur për këtë qëllim.

Në vazhdim diskutimi në fokus grup ka filluar me reflektim mbi aspektet më të ndjeshme të teksteve shkollore (aspektet që ata i kanë vlerësuar si më të dobëta), sfidat kryesore me të cilat mësime të përballen gjatë punës me tekstet shkollore dhe zgjidhjet të cilat ata i aplikojnë.

³⁹ Mësime të lëndëve: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, TIK, histori, gjeografi.

Përmbledhje e të dhënave në pyetësorë dhe diskutimeve në fokus grup

Aspektet e vlerësuara	Të dhënat e përmbledhura nga pyetësorët për cilësinë e teksteve shkollore ⁴⁰	Konkluzionet e diskutimeve
Përmbajtja e teksteve shkollore	<p>Në kuadër të kriterëve që përcaktojnë cilësinë e përmbajtjes së teksteve shkollore, aspektet më të ndjeshme janë vlerësuar të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Mungesa e relevancës së përmbajtjes për arritjen e rezultateve të të nxënit të përcaktuara me kurrikulat bërthamë; ● Mungesa e referencës në burimet e informacionit; ● Konceptet nuk janë gjithnjë të sakta dhe idetë nuk janë koherente; shembujt dhe ilustrimet nuk janë interesante dhe relevante për përvojat e nxënësve; ● Konceptet e reja nuk prezantohen në mënyrë adekuate, në momentin dhe mënyrën e duhur si dhe ka ndërlidhje të pamjaftueshme me informatat paraprake të nxënësve; ● Niveli i vështirësisë nuk i përshtatet nivelit kognitiv të nxënësve dhe kërkesave kurrikulare; 	<p>Shpërputhje e madhe me kurrikulën dhe programin mësimor (p.sh. deri në 50% në tekstet e historisë për gjimnaz, apo rreth 40% në tekstet e gjeografisë për nivelin e mesëm të ulët);</p> <p>Gabimet shkencore janë të pranishme;</p> <p>Përmbajtja nuk është aktuale (e vjetëruar) dhe është e stërngarkuar (me përmbajtje, shifra, formula dhe detyra).</p> <p>Niveli i vështirësisë nuk i përshtatet nivelit kognitiv të nxënësve.</p> <p>Radhitja e njësive shpesh nuk është adekuate.</p> <p>Korrelacioni ndër-lëndor shpesh mungon (duke pamundësuar jo vetëm qasjen e integruar por edhe realizimin e njësive të caktuara mësimore-në mungesë të informatave paraprake që është dashur të përvetësohen në kuadër të lëndës tjetër);</p> <p>Raste kur pjesë të përmbajtjes përsëriten nga klasa në klasë, për dy-tre vite radhas, pa asnjë ndryshim (p.sh. në tekstin e gjuhës shqipe për nivelin e mesëm të ulët);</p> <p>Ilustrimet dhe shembujt nuk janë relevant (për jetën dhe përditshmërinë e nxënësve).</p>

40 Pyetësorët e plotësuar nga pjesëmarrësit në fokus grup.

<p>Mësimdhënia dhe mësimnxënja (aspektet pedagogjike/didaktike)</p>	<p>Pikat më të ndjeshme në kuadër të kësaj komponente janë vlerësuar të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Tekstet nuk i kushtojnë vëmendjen e nevojshme zhvillimit të shkathtësive të larta intelektuale; ● Përmbajtjet nuk kultivojnë vlera dhe qëndrime pozitive në mënyrë adekuate dhe të mjaftueshme; ● Përmbajtja nuk mund të shfrytëzohet në mënyrë fleksibile, konform aftësive dhe stileve të ndryshme të të nxënësve; ● Teksti nuk mund të përdoret në mënyrë të pavarur nga nxënësi, në mënyrë që të kuptoj rezultatet e njësive mësimore, të bëjë vet-vlerësim dhe të planifikoj të nxënësve e mëtejshëm). 	<p>Tekstet nuk mundësojnë përfshirjen aktive të nxënësve në procesin e të nxënësve;</p> <p>Kërkesat/detyrat shpesh nuk korrespondojnë me tekstin bazë (si dhe mungojnë burimet/referencat për lexim shtesë);</p> <p>Kërkesat/detyrat nuk mundësojnë llojllojshmëri përgjigjesh;</p> <p>Kërkesat/detyrat në kuadër të shkencave të natyrës nuk ofrojnë mundësi për realizim në kushte shtëpie, me materiale nga jeta e përditshme (supozojnë punë laboratorike).</p>
<p>Gjuha, struktura dhe organizimi i përmbajtjes</p>	<p>Në kuadër të kësaj komponente, pikat më të ndjeshme janë vlerësuar të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Gjuha e përdorur nuk është interesante për nxënësit; ● Ndarja e njësive mësimore nuk është e përshtatshme dhe logjike; ● Rezultatet e të nxënësve nuk ofrohen në fillim të njësive mësimore dhe as kriteret e suksesit në fund të tyre. 	<p>Gjuha e përdorur është shumë akademike dhe e thatë;</p>
<p>Faqosja dhe ilustrimet</p>	<p>Shqetësimi kryesor i mësimdhënësve në kuadër të kësaj komponente i referohet ilustrimeve jo adekuate, jo cilësore dhe të papërshtatshme për ta stimuluar dhe lehtësuar nxënësin.</p>	

Aspekte të tjera:

- Për nivelin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë Libri i mësuesit mungon.
- Në kuadër të trajnimeve të mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës së re, përgatitjes së tyre për punë me tekste të vjetra nuk i është kushtuar vëmendje e mjaftueshme. Edhe udhëzimet e ofruara në kuadër të Kurrikulave bërthamë dhe Programeve mësimore i referohen kryesisht rëndësisë së shfrytëzimit të materialeve mësimore dhe burimeve të ndryshme, por nuk përmbajnë orientime konkrete për punë me tekstet e vjetra.
- Reflektimet e mësimdhënësve për cilësinë e teksteve shkollore deri më tani nuk janë marrë parasysh.

FOKUS GRUPI I TRETË ME MËSIMDHËNËS

Datë: 21/03/2019

Koha: 10.00-12.00

Qëllimi i takimit: Diskutim për cilësinë e teksteve shkollore nga perspektiva e përshtatjes së tyre me kërkesat dhe parimet e Kornizës Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Kosovë.

Pjesëmarrësit në fokus grup: 10 mësimdhënës të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët nga shkollat fillore dhe të mesme të ulëta “Faik Konica” Prishtinë, “Xhemajl Mustafa”, Prishtinë, “Gjergj Fishta” Prishtinë, “Mileniumi 3” Prishtinë, “Ibrahim Rugova” Obiliq, “Anton Zako Cajupi” Vushtrri dhe “Ismail Luma” Lipjan⁴¹.

⁴¹ Mësimdhënës të lëndëve: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, TIK, histori, gjeografi.

Përmbledhje e të dhënave në pyetësorë dhe diskutimeve në fokus grup

Aspektet e vlerësuara	Të dhënat e përmbledhura nga pyetësorët për cilësinë e teksteve shkollore ⁴²	Konkluzionet e diskutimeve
Përmbajtja e teksteve shkollore	<p>Në kuadër të kriterëve që përcaktojnë cilësinë e përmbajtjes së teksteve shkollore, aspektet më të ndjeshme janë vlerësuar të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Mungesa e relevancës së përmbajtjes për arritjen e rezultateve të të nxëniet të përcaktuara me kurrikulat bërthamë; ● Konceptet nuk janë gjithnjë të sakta dhe idetë nuk janë koherente; shembujt dhe ilustrimet nuk janë interesante dhe relevante për përvojat e nxënësve; ● Prezantim jo adekuat i koncepteve të reja (në momentin dhe mënyrën e duhur)... ndërlihdja e pamjaftueshme me informatat paraprake të nxënësve; ● Mungesë e balancit në gjerësinë dhe thellësinë e trajtimit të temave; ● Prani e përmbajtjeve të tepërta, që nuk janë në funksion të drejtpërdrejtë të arritjes së rezultateve të përcaktuara me KB; ● Konsideratë e pamjaftueshme për informatat dhe përvojën parake të nxënësve; ● Niveli i vështirësisë nuk i përshtatet nivelit kognitiv të nxënësve dhe kërkesave kurrikulare; ● Lista e burimeve të rekomanduara për lexim shtesë nuk ofrohet. 	<p>Shpërputhje me kurrikulën dhe programin mësimor të lëndës përkatëse; Mungesë korrelacioni ndër-kurrikular (p.sh. në lëndën e fizikës mësohen madhësitë në fillim të vitit, ndërsa në lëndën e matematikës nuk është mësuar presja dhjetore); Përmbajtja nuk është aktuale (e vjetëruar) dhe është e stërngarkuar (me tekst, shifra, formula dhe detyra); Niveli i vështirësisë nuk i përshtatet nivelit kognitiv të nxënësve; Radhitja e njësive shpesh nuk është adekuate; Ilustrimet dhe shembujt nuk janë relevant (për jetën dhe përditshmërinë e nxënësve).</p>
Mësimdhënia dhe mësimnxënja (aspektet pedagogjike/didaktike)	<p>Pikat më të ndjeshme në kuadër të kësaj komponente janë vlerësuar të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Tekstet nuk i kushtojnë vëmendjen e nevojshme zhvillimit të shkathtësive të larta intelektuale; ● Përmbajtja nuk mund të shfrytëzohet në mënyrë fleksibile, konform aftësive dhe stileve të ndryshme të të nxëniet; ● Aktivitetet e nxënies nuk u mundësojnë nxënësve që në mënyrë aktive të integrojnë, praktikojnë dhe zbatojnë dijen e re; ● Aktivitetet e nxënies nuk janë interesante; nuk i motivojnë nxënësit për të mësuar; ● Instruksionet nuk janë të qarta; ● Detyrat/kërkesat nuk mundësojnë stile të ndryshme të përgjigjes/zgjidhjes; ● Teksti nuk i mundëson nxënësit t'i kuptojnë rezultatet e njësive mësimore, të bëjnë vet-vlerësim dhe të planifikojnë të nxëniet e mëtejshme. 	<p>Tekstet nuk mundësojnë përfshirjen aktive të nxënësve në procesin e të nxëniet; Teksti bazë dhe Fletorja e punës nuk korrespondojnë (janë nga botues të ndryshëm); Detyrat/kërkesat nuk lidhen me jetën/përditshmërinë e nxënësve.</p>

42 Pyetësorët e plotësuar nga pjesëmarrësit në fokus grup.

Gjuha, struktura dhe organizimi i përmbajtjes	<p>Në kuadër të kësaj komponente, pikat më të ndjeshme janë vlerësuar të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Gjuha e përdorur nuk është e interesante për nxënësit; ● Ndarja e njësive mësimore nuk është e përshtatshme dhe logjike; ● Rezultatet e të nxënit nuk ofrohen në fillim të njësive mësimore dhe as kriteret e suksesit në fund të tyre. 	Gjuha e përdorur është shumë akademike dhe e thatë (ka raste kur pjesë të përmbajtjes në lëndën e matematikës janë plotësisht të ngjashme/të njëjta me përmbajtje në tekstet universitare).
Faqosja dhe ilustrimet	Shqetësimi kryesor i mësimdhënësve në kuadër të kësaj komponente i referohet ilustrimeve jo adekuate, jo cilësore dhe të papërshtatshme për ta stimuluar dhe lehtësuar nxënien.	

Aspekte të tjera:

- Për nivelin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë Libri i mësuesit mungon;
- Në kuadër të trajnimeve të mësimdhënësve për zbatimin e kurrikulës së re, përgatitjes së tyre për punë me tekste të vjetra nuk i është kushtuar vëmendje e mjaftueshme. Edhe udhëzimet e ofruara në kuadër të Kurrikulave bërthamë dhe Programeve mësimore i referohen kryesisht rëndësisë së shfrytëzimit të materialeve mësimore dhe burimeve të ndryshme, por nuk përmbajnë orijentime konkrete për punë me tekstet e vjetra;
- Me rastin e ribotimeve, gabimet (as ato teknike/shkencore) nuk korrigjohen;
- Reflektimet e mësimdhënësve për cilësinë e teksteve shkollore deri më tani nuk janë marrë parasysh;
- E drejta e shkollave për përzgjedhjen e teksteve shkollore nuk përfilllet.

FOKUS GRUPI I KATËRT ME MËSIMDHËNËS

Datë: 22/03/2019

Koha: 13.00-15.00

Qëllimi i takimit: Diskutim për cilësinë e teksteve shkollore nga perspektiva e përshtatjes së tyre me kërkesat dhe parimet e Kornizës Kurrikulare për Arsimin Parauniversitar në Kosovë.

Pjesëmarrësit në fokus grup: 15 mësimdhënës të nivelit të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë nga shkollat fillore dhe të mesme të ulëta “Ganimete Tërbeshi” Llukar, “Emin Duraku” Gjakovë, “Kuvendi i Lezhës” Viti, “Mulla Idrizi” Gjilan dhe “Isa Boletini” Rahovec, nga gjimnazet “Xhevdet Doda” Prishtinë, “Hivzi Sylejmani” Fushë Kosovë, “Xhavit Ahmeti” Gjilan, Gjimnazi në Istog dhe Sh.M. Ekonomike në Gjakovë⁴³.

Rrjedha e takimit: Në pjesën e parë të takimit, pjesëmarrësit në mënyrë individuale kanë reflektuar perspektivën e tyre për cilësinë e teksteve shkollore me të cilat punojnë aktualisht, në pyetësorët e përgatitur për këtë qëllim.

Në vazhdim diskutimi në fokus grup ka filluar me reflektim mbi aspektet më të ndjeshme të teksteve shkollore (aspektet që ata i kanë vlerësuar si më të dobëtat), sfidat kryesore me të cilat mësimdhënësit përballen gjatë punës me tekstet shkollore dhe zgjidhjet të cilat ata i aplikojnë.

43 Mësimdhënës të lëndëve: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, edukatë qytetare, biologji, kimi, fizikë, matematikë, gjeografi, histori, filozofi-sociologji.

Përmbledhje e të dhënave në pyetësorë dhe diskutimeve në fokus grup

Aspektet e vlerësuara	Të dhënat e përmbledhura nga pyetësorët për cilësinë e teksteve shkollore ⁴⁴	Konkluzionet e diskutimeve
Përmbajtja e teksteve shkollore	<p>Në kuadër të kriterëve që përcaktojnë cilësinë e përmbajtjes së teksteve shkollore, aspektet më të ndjeshme janë vlerësuar të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Mungesa e relevancës së përmbajtjes për arritjen e rezultateve të të nxënësve të përcaktuara me kurrikulat bërthamë; ● Konceptet nuk janë gjithnjë të sakta dhe idetë nuk janë koherente; shembujt dhe ilustrimet nuk janë interesante dhe relevante për përvojat e nxënësve; ● Konceptet e reja nuk prezantohen në mënyrë adekuate (në momentin dhe mënyrën e duhur)... ndërlidhje e pamjaftueshme me informatat paraprake të nxënësve; ● Mungon balansi i nevojshëm në gjerësinë dhe thellësinë e trajtimit të temave; ● Prani e përmbajtjeve të tepërta, që nuk janë në funksion të drejtpërdrejtë të arritjes së rezultateve të përcaktuara me KB; ● Ka përsëritje të panevojshme të temave; ● Konsideratë e pamjaftueshme për informatat dhe përvojën parake të nxënësve; ● Niveli i vështirësisë nuk i përshtatet nivelit kognitiv të nxënësve dhe kërkesave kurrikulare; ● Lista e burimeve të rekomanduara për lexim shtesë nuk ofrohet. 	<p>Shpërputhje e madhe me kurrikulën dhe programin mësimor;</p> <p>Korrelacioni ndër-lëndor shpesh mungon (p.sh. ndërmjet lëndës së gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze; ndërmjet fizikës dhe matematikës; ndërmjet biologjisë dhe kimisë, apo gjeografisë dhe historisë);</p> <p>Përmbajtja shpesh përmban lëshime/gabime shkencore (p.sh. teksti i gjenetikës për klasën 11);</p> <p>Konceptet nuk definojnë profesionalisht (p.sh. në lëndën e fizikës);</p> <p>Niveli i vështirësisë nuk i përshtatet zhvillimit kognitiv të nxënësve; temat ndonjëherë janë shumë të thjeshta, e ndonjëherë shumë të avancuara;</p> <p>Përmbajtjet janë të stërngarkuara (me tekst, shifra, formula);</p> <p>Radhitja e njësive shpesh nuk është adekuate (p.sh. në lëndën e fizikës për nivelin e mesëm të ulët, izotopet radioaktive para radioaktivitetit);</p> <p>Temat kryesore ndonjëherë propozohen në kuadër të pjesës zgjedhore (p.sh. në kuadër të lëndës së fizikës, relativiteti I lëvizjes ose rryma në lëngje);</p> <p>Tema të caktuara përsëriten pa nevojë nga klasa në klasë (p.sh. në tekstet e sociologjisë për klasën 11 dhe 12);</p> <p>Ilustrimet dhe shembujt nuk janë relevant (për jetën dhe përditshmërinë e nxënësve).</p>

44 Pyetësorët e plotësuar nga pjesëmarrësit në fokus grup.

<p>Mësimdhënia dhe mësimnxënja (aspektet pedagogjike/didaktike)</p>	<p>Pikat më të ndjeshme në kuadër të kësaj komponente janë vlerësuar të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Fokus i pamjaftueshëm i teksteve në zhvillimin e shkathtësive të larta intelektuale; ● Përmbajtja nuk mund të shfrytëzohet në mënyrë fleksibile, konform aftësive dhe stileve të ndryshme të të nxënësve; ● Aktivitetet e nxënies nuk u mundësojnë nxënësve që në mënyrë aktive të integrojnë, praktikojnë dhe zbatojnë dijen e re; ● Aktivitetet e nxënies nuk janë interesante; nuk i motivojnë nxënësit për të mësuar; ● Instruksionet nuk janë të qarta; 	<p>Tekstet nuk mundësojnë përfshirjen aktive të nxënësve në procesin e të nxënësve;</p> <p>Kërkesat/detyrat ofrohen vetëm në fund të çdo kapitulli dhe jo në fund të çdo njësie mësimore (në nivelin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë);</p> <p>Kërkesat/detyrat në kuadër të shkencave të natyrës nuk ofrojnë mundësi për realizim në kushte 'shtëpie', me materiale nga jeta e përditshme (supozojnë punë laboratorike).</p>
<p>Gjuha, struktura dhe organizimi i përmbajtjes</p>	<p>Në kuadër të kësaj komponente, pikat më të ndjeshme janë vlerësuar të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Gjuha e përdorur nuk është interesante për nxënësit; ● Ndarja e njësive mësimore nuk është e përshtatshme dhe logjike; ● Rezultatet e të nxënësve nuk ofrohen në fillim të njësive mësimore dhe as kriteret e suksesit në fund të tyre. 	<p>Teksti shpesh përmban gabime ortografike dhe drejtshkrimore; lidhja sintaksore e fjalëve në fjali shpesh ka mangësi.</p>
<p>Faqosja dhe ilustrimet</p>	<p>Shqetësimet kryesore të mësimdhënësve në kuadër të kësaj komponente i referohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> ● Organizimit joadekuat të materialit, për të lehtësuar nxënien dhe ● Ilustrimeve jo adekuate, jo cilësore dhe të papërshtatshme për ta stimuluar dhe lehtësuar nxënien. 	

Aspekte të tjera:

- Programet mësimore për disa lëndë vazhdojnë të jenë të ngarkuara (p.sh. program mësimor i lëndës së gjeografisë për klasën VIII ka 14 faqe rezultate, që duhen arritur gjatë një viti shkollor);
- Përkundër idesë që kurrikula e re të mundësoj përshtatje më të mirë me aftësitë kognitive të nxënësve, përvojat e deritanishme dëshmojnë të kundërtën (në disa lëndë, tekstet që shfrytëzohen janë të klasëve pasuese p.sh. në klasën e VII në lëndën e biologjisë shfrytëzohen tekstet e klasës së IX);
- Materiali shtesë për fëmijët me aftësi të kufizuara mungon.

Shtojca 5: Pyetësi për vlerësimin e teksteve shkollore, i realizuar me mësimdhënësit pjesëmarrës në fokus grupe

Vlerësim i teksteve shkollore nga mësimdhënësit

Shkolla: _____

Niveli/shkalla kurrikulare: _____

Lënda: _____

Datë: _____

PËRMBAJTJA E TEKSTEVE SHKOLLORE

	Jo	Pjesërisht	Po	Komente
Përmbajtja është aktuale dhe relevante për arritjen e rezultateve të të nxëniet të përcaktuara me kurrikulën bërthamë (RN)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Burimet e informacionit janë referuar në mënyrë adekuate	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Konceptet janë të sakta dhe precize. Idetë janë koherente. Ka shembuj dhe ilustrime të mjaftueshme. Shembujt dhe ilustrimet janë interesante dhe relevante për përvojat e nxënësve.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Konceptet e reja bazohen në të vjetrat dhe prezantohen në mënyrë adekuate (në momentin dhe mënyrën e duhur)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ka baraspeshë në gjerësinë dhe thellësinë e trajtimit të temave	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Niveli i vështirësisë i përshtatet nivelit kognitiv të nxënësve dhe kërkesave kurrikulare	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Sasia e përmbajtjes është adekuate (nuk ka përmbajtje të tepërt apo të pamjaftueshme)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Vëmendje e veçantë i kushtohet informatave dhe përvojës paraprake të nxënësve	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

Ofrohet perspektivë e shumëfishtë për çështjet e caktuara	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Përmbajtja dhe ilustrimet nuk janë diskriminuese (në bazë të gjinisë, etnisë, religjionit, etj.)	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Për të inkurajuar leximin e mëtejsh nga nxënësit, lista e burimeve të rekomanduara është dhënë në fund të çdo teme	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

MËSIMDHËNIA DHE MËSIMNXËNIA

	Jo	Pjesërisht	Po	Komente
Tekstet mundësojnë zhvillim të shkathhtësive kognitive në të gjitha nivelet ⁴⁵	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Kultivohen vlerat dhe qëndrimet pozitive	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Përmbajtja është organizuar në pjesë të përshtatshme (të pavarura ose me ndërlidhje fleksibile), për të mundësuar shfrytëzim fleksibil konform aftësive dhe stileve të ndryshme të të nxënësve	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Aktivitetet e nxënësve u mundësojnë nxënësve që në mënyrë aktive të integrojnë, praktikojnë dhe zbatojnë dijen e re.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Aktivitetet e nxënësve janë interesante. Ato i motivojnë nxënësit për të mësuar.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Aktivitetet e nxënësve kanë instruksione të qarta.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Aktivitetet/detyrat mundësojnë stile të ndryshme të përgjigjes (konform stileve të ndryshme të nxënësve). Ato u mundësojnë nxënësve të kuptojnë qëllimet kryesore të njësive përkatëse mësimore, të vet-vlerësojnë atë që kanë mësuar dhe të planifikojnë përmirësimin/avancimin e nxënësve të tyre.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

45 Shkathhtësitë e larta intelektuale që kërkojnë analizë, vlerësim, gjykim dhe jo vetëm mbamendje të fakteve, përfshihen në mënyrë graduale duke u bazuar në aftësitë dhe nevojat zhvillimore të fëmijëve.
- Përpunimi i thellë i informacionit, të menduarit kritik dhe kreativ inkurajohen duke i përfshirë nxënësit në procese më pak të strukturuar dhe përmes pyetjeve të hapura e referencave për lexim të metejshëm.

GJUHA, STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES

	Jo	Pjesërisht	Po	Komente
Gjuha e përdorur i përshtatet aftësive gjuhësore të nxënësve.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Gjuha e përdorur është e njohur dhe interesante për nxënësit.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ndarja e njësive mësimore është e përshtatshme dhe logjike	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Rezultatet e të nxënit janë dhënë në fillim dhe një përmbledhje në fund të çdo njësie/kapitulli	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

GJUHA, STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I PËRMBAJTJES

	Jo	Pjesërisht	Po	Komente
Materiali është organizuar mirë, hapësira dhe margjinat janë shfrytëzuar në mënyrë adekuate për të lehtësuar nxënien	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Ilustrimet janë adekuate, efektive dhe të përshtatshme për të stimuluar dhe lehtësuar nxënien. Ato shërbejnë për ta fokusuar nxënësin në përmbajtjen e caktuar dhe jo për ta shpërqendruar nga ajo. Ilustrimet dhe fotografitë nuk janë vetëm si dekor por plotësim i tekstit/prezantimit të dhënë përmes tekstit.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>
Madhësia e shkronjave është adekuate për të mundësuar lexim komod.	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>	<input type="radio"/>

